

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 74</i>
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosoves / Vlada Kosoves / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development		Sektor: <i>Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	<i>0113</i>	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	<i>634</i>
Nr. i faqeve Str. shanica No. pages	<i>74</i>	Data Datum Date	<i>13.03.15</i>
PRISHTINE/A			




OPERATORI KOSOVA S.A. / KOSTT S.C.	
TRANSMISORITETI I TELEKOMUNIKACIONIT / TELECOM OPERATOR KOSTT S.C.	
OPERATORI I TELEKOMUNIKACIONIT / TELECOM OPERATOR	
Nr. <i>174</i>	Dt. <i>12/03/2015</i>
PRISHTINE-A	


KOSTT

Raport Vjetor 2014

(01.01.2014-31.12.2014)


Vendimi -150305-II/5
 Bordi i Drejtorëve në mbledhjen 59/15 të mbajtur me 5 mars 2014 njëzëri miratoi Raportin vjetor për vitin 2014.

	Përgatit	Kontrollon	Aprovon
Emri Mbiemri	Nebih Haziri - Zyrtar Kryesor për Financa dhe Trezor	Naim Bejtullahu - Kryeshf Ekzekutiv	Ramadan Paçarada - Kryesuesi i BD
Nënshkrimi			
Data	<i>2 Mars, 2015</i>	<i>2 Mars 2015</i>	<i>5 mars 2015</i>


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 2 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2014

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2014
2	Dërguesi i dokumentit	Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Përmbajtja Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT</p> <p>1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve 1.1. Aktivitete kryesore të ndërmara gjatë vitit 1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja 1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv 1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual 1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it 1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm 1.7. Infomacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën 1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit</p> <p>2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv 2.1. Arritjet kryesore 2.2. Ngjarjet kryesore të vitit 2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës 2.3.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2014 2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit 2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit 2.3.4. Operimi i tregut 2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet 2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare 2.4. Progresi me planin e biznesit 2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2014 2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm 2.7. Rreziqet</p> <p>Anekset</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		<p>1. Sponzorimet dhe donacionet</p> <p>2. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike</p> <p>2.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit</p> <p>2.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>2.3. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2014 nga burimet e KOSTT</p> <p>2.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës</p> <p>Lista e shkurtesave</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2014 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Ky Raport është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe sipas “Udhëzuesit për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, Raporti dërgohet në Njësinë për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2014 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të KOSTT-it

Viti 2014 në KOSTT është karakterizuar me një aktivitet të ngjeshur në investiv dhe me procesin e integrimi regjionale, i qeverisur nga Bordi dhe menaxhmenti me nxitje të efikasitetit dhe rritje të qëndrueshmërisë ekonomike, me shtimin e besimit të investitorëve dhe me arritjen e objektivave dhe qëllimeve të përcaktuara që janë në interes të ndërmarrjes dhe aksionarit me rritje të transparencës dhe afarizmit efikas.

KOSTT është ndërmarrja e parë publike në Kosovë e cila ka marrë kredi komerciale në BERZH pa garancion shtetëror për realizimin e programit investiv për vitet vijuese, kjo dëshmon pjekurinë udhëheqëse dhe qëndrueshmërinë financiare të ndërtuar nga menaxhmenti dhe Bordi i KOSTT. Gjithashtu gjatë vitit 2014 ka gjithashtu ka filluar implementimi i projektit madhor për ndërtimin e linjës 400kV Kosovë - Shqipëri.


Zhvillim tjetër i rëndësishëm për KOSTT është nënshkrimi i marrëveshjes ndër OST ndërmjet KOSTT dhe EMS, sipas të cilës KOSTT do të operoj si zonë e pavarur kontrolluese, dhe e cila i hap rrugë integritit të plotë të KOSTT në mekanizmat dhe proceset regjionale.

Në anën tjetër KOSTT ka vazhduar angazhimin në përmirësimin e performancës teknike në kuptim të mirëmbajtjes së balancës së sistemit, dhe ngritjes së nivelit të disponueshmërisë së rrjetit të transmisionit.

Përkundër angazhimeve të shumta punonjësit e KOSTT kanë mbetur të përkushtuar dhe me sukses është përmbyllur një vit i cili ka shënuar arritje të shumta dhe njëkohësisht të veçanta.

Sinqerisht,

Ramadan Paçarada
u.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT -it


Në vazhden e avancimit të KOSTT në vitin 2014 përqendrimi kryesor i menxhamentit ka qenë në sigurimin e mjeteve për investimet kapitale të KOSTT dhe inkuadrimi i KOSTT në mekanizmat regjional dhe evropian.

Në vitin 2014 KOSTT ka përmbyllur konstruksionin financiar të planit zhvillimor dhe investiv 2013-2017, pra nga institucionet financiare ndërkombëtare janë siguruar mjetet në formë të kredive të buta dhe granteve për realizimin e investimeve kapitale për periudhën në fjalë. Konkretisht, në vazhden bashkëpunimit me KfW dhe BE janë siguruar mjetet në vlerë prej 23.5 milion, përkatësisht 7.35 milion si financim i kombinuar prej grantit dhe kredisë. Gjithashtu KOSTT ka lidhur marrëveshje për kredi me BERZH për huazimin e 30 milion për financimin e projekteve të cilat i shërbejnë ngarkesës.

Kjo dëshmon besimin e partnerëve të KOSTT në strukturat e udhëheqëse dhe dëshmon qëndrueshmërinë financiare të KOSTT e cila është ngritur mbi bazën e parimeve të shëndetshme, gjithnjë duke pasur parasysh optimizimin dhe kthimin e vlerave për konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Në aspektin praktik të implementimit të projekteve vlen të veçohet fillimi i implementimit të projektit të linjës 400kV Kosovë - Shqipëri, progresi i të cilit në fazat fillestare duket mjaft premtues.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2014 ka pasur një angazhim gjithëpërfshirës për implementimin e marrëveshjes për energji ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku roli i KOSTT ka qenë pothuajse qendror. Në implementim të kësaj marrëveshje KOSTT pas një pune intensive ka nënshkruar marrëveshjen ndër OST me EMS, me të cilën KOSTT-it i hapet rruga për pjesëmarrje në mekanizmat regjional dhe evropian, dhe më kryesorja me të cilin njihet mëvetësia dhe barabarësia e KOSTT me OST tjera të regjionit. Për më tepër, KOSTT është duke punuar me përkushtim të madh në përmbushjen e kërkesave dhe standardeve

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

të ENTSO-E për të filluar operimin e pavarur si zonë kontrolluese dhe anëtarësimin në këtë organizatë.


KOSTT ka qenë mjaft aktiv edhe në proceset aktuale në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në projektin për TC Kosova e Re dhe hartimin e ligjeve të reja të energjisë në përshtatje të Pakos së Tretë të BE dhe implementimit të obligimeve nga Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë në EJJ.

Falë organizimit, përkushtimit vetëmohues të të gjithë punonjëseve të KOSTT dhe ndarjes së përshtatshme të detyrave KOSTT ka arritur që të përmbushë dhe tejkaloj të gjitha objektivat e përcaktuara me planet strategjike, dhe atë gjithnjë duke respektuar kërkesat ligjore dhe rregullative.

Gjithashtu vlen të theksohet se operimi i sistemit të transmisionit edhe gjatë vitit 2014 ka qenë në nivel të performancës së lartë ashtu edhe si shihet në indikatorët të treguar në raport.

Sinqerisht,

Naim Bejtullahu
Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2014 KOSTT-i ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të qeverisjes korporative bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktivitetet kryesore në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT-it. Në bazë të vendimit numër 01/119 të Qeverisë së Republikës së Kosovës KOSTT përcaktohet si Kompani Publike e kategorisë së parë.

Gjatë vitit 2014 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka qenë në përbërjen vijuese:

1. Ramadan Paçarada, u.d. Kryesues i Bordit
2. Nazmi Mikullovc, Anëtarë i Bordit
3. Lutfi Maxhuni, Anëtarë i Bordit
4. Fatos Ukaj, Anëtarë i Bordit
5. Faton Deda, Anëtarë i Bordit (ka dhenë dorëheqje nga Bordi i Drejtorëve me datë 14 nëntor 2014)
6. Naim Bejtullahu, Kryshef Ekzekutiv, Anëtarë i Bordit


Nga data 29 janar 2014 Ministri i Zhvillimit Ekonomik me vendimin nr. 01/178 ka emëruar përbërjen e re të Komisionit të Auditimit, për arsye se i njëjti nuk ka qenë i kompletuar.

Përbërja e Komisionit të Auditimit nga data 29 janar 2014 ka qenë si në vijim:

1. Fatos Ukaj, Kryesues
2. Nazmi Mikullovc, Anëtarë
3. Lutfi Maxhuni, Anëtarë

Gjatë vitit 2014 Komisioni i Auditimit ka mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje.

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit, të Komisionit të Auditimit dhe të Komisioneve të tjera, raportimi dhe dërgimi i infomatave Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) siç kërkohen sipas nenit 31, 32 dhe 37 të Ligjit për NP, janë kryer në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore. Gjatë vitit 2014 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 9 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

it ka mbajtur gjithësejt 10 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme, si dhe mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera dhe Informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të KOSTT-it.


Në çdo mbledhje Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Komisionit të auditimit dhe rekomandimet, si dhe sipas nevojës edhe raportet e Komisioneve të përkohshme siç janë: Komisioni për investime kapitale, Komisioni për shqyrtimin e operimit, dhe Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore. Ndërsa pas përfundimit të mandatit të komisioneve paraprake, gjithashtu edhe Komitetit për financa, Komitetit për staf dhe shpërblime dhe Komitetit për hulumtim dhe teknologji.

Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të themeluara nga Bordi janë prezantuar si materiale në mbledhjet e Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efikasitet më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur vendimet kryesore që janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2014 duke mos i përfshirë mbledhjet dhe konsultimet e Zyrtarëve të Kompanisë, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Auditorit të Brendshëm me Bordin dhe Zyrtarët e Njësisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, raportimet dhe aktivitetet e ngjashme korporative.

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raport tremujor për periudhën Tetor -Dhjetor 2013, Raport tremujor për periudhën Janar - Mars 2014, Raport tremujor për periudhën Prill-Qershor 2014 dhe Raport tremujor për periudhën Korrik-Shtator 2014
2	Raporti i Komisionit për regjistrimin e pasurisë të KOSTT-it për vitin 2014 (Elaborati i regjistrimit të asetëve)
3	Plani i Biznesit për vitin 2015
4	Buxheti për vitin 2015
5	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve (BtD) dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2015
6	Raporti Vjetor i punës së KOSTT-it për vitin 2013

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

7	Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare Rregullative për vitin 2013
8	Plani i Biznesit i reviduar për vitin 2014
9	Plani i Prokurimit për vitin 2015
10	Pjesëmarrja e KOSTT në cilësinë e aksionarit në Zyren për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve interkonektive (SEE CAO)
11	Ndryshimi dhe plotësimi i Deklaratës për Kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrarët e KOSTT
12	Marrëveshja për kredi me BERZH
13	Rritja e kapitalit themeltar të në Zyren për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve interkonektive (SEE CAO)
14	Amandamenti i Kodit Disiplinor të KOSTT

1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja

Gjatë vitit 2014 Komisioni i Auditimit ka vlerësuar të gjitha raportet tremujore, raportin vjetor të vitit 2013, Raportin e Auditorit të Jashtëm në KOSTT, raportet e auditorit të brendshëm, propozim Buxhetin për vitin 2014, revidimin e buxhetit për vitin 2014, Planin e Biznesit për vitin 2015, politikat, Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2015, Planin e prokurimit dhe raporte të tjera.

Përbërja dhe struktura e Komisioneve të përkohshme të Bordit gjatë vitit 2014 ka qenë si në vijim:

Komisioni për investime kapitale (ka funksionuar deri me 31 qershor 2014)


1. Nazmi Mikullovc, Kryesues
2. Ramadan Paçarada, Anëtar
3. Lutfi Maxhuni, Anëtar

II. Komisioni për operim (ka funksionuar deri me 31 qershor 2014)

1. Fatos Ukaj, Kryesues
2. Nazmi Mikullovc, Anëtar
3. Ramadan Paçarada, Anëtar

III. Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore (ka funksionuar deri me 31 qershor 2014)

1. Lutfi Maxhuni, Kryesues
2. Fatos Ukaj, Anëtar
3. Faton Deda, Anëtar

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Komisioni për investime kapitale ka mbajtur dy (2) mbledhje.
 Komisioni për shqyrtimin e operimit ka mbajtur dy (2) mbledhje
 Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore ka mbajtur dy (2) mbledhje.

Ndërsa, Bordi në mbledhjen e 52 ka marrë vendim për formimin e komisioneve të përkohshme, me mandat prej gjashtë muajve, duke filluar nga 1 gusht 2014 deri me 31 janar 2015, në përbërjen vijuese:

- I. Komisioni për financa**
 1. Ramadan Paçarada, Kryesues
 2. Nazmi Mikullovc, Anëtarë
 3. Lutfi Maxhuni, Anëtarë

- II. Komisioni për staf dhe shpërblime**
 1. Fatos Ukaj, Kryesues
 2. Lutfi Maxhuni, Anëtarë
 3. Ramadan Paçarada, Anëtarë

- III. Komisioni për hulumtime dhe teknologji**
 1. Nazmi Mikullovc, Kryesues
 2. Ramadan Paçarada, Anëtar
 3. Faton Deda, Anëtarë


Komisioni për financa gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjithsejtë dy (2) mbledhje.
 Komisioni për staf dhe shpërblime gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjithsejtë dy (2) mbledhje.
 Komisioni për hulumtime dhe teknologji gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjithsejtë dy (2) mbledhje.

1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2014 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:

Ramandan Paçarada, (u.d) Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it (Anëtar i Komisionit të Auditimit, Kryetar i Komisionit për projekte kapitale; anëtarë i Komisionit për investime kapitale, anëtar i Komisionit për shqyrtimin e operimit; anëtarë i Komiteit për hulumtime dhe teknologji, anëtarë i Komitetit për staf dhe shpërblime, kryesues i Komitetit për financa), me profesion: ekonomist
 Gjithsejtë kompensimet 2014: 13,740 □ (Bruto) + Performanca e vitit 2013: 4,105.86 □ (Bruto)

Faton Deda, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it (anëtar i Komisionit për shqyrtimin e operimit, anëtarë i Komitetit për hulumtime dhe teknologji), me profesion: inxhinier

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Gjithsejtë kompensimet 2014: 9,075 □ (Bruto) + Performanca e vitit 2013: 3,662.8 □ (Bruto)

Fatos Ukaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; Kryesues i Komisionit të Auditimit; kryesues i Komisionit për shqyrtimin e operimit; anëtar i Komisionit për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore, Kryesues i Komitetit për staf dhe shpërblime); me profesion: ekonomist - profesor universitar.

Gjithsejtë kompensimet 2014: 13,770 Euro (Bruto) + Performanca e vitit 2013: 3,622.8 □ (Bruto)

Lutfi Maxhuni, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, (kryesues i Komisionit për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore; anëtar i Komisionit për investime kapitale; me profesion: ekonomist

Gjithsejtë kompensimet 2014: 13,470 □ (Bruto) + Performanca e vitit 2013: 3,622.8 □ (Bruto)

Nazmi Mikullovc, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT; kryesues i Komisionit për investime kapitale; anëtarë i Komisionit për shqyrtimin e operimit ; me profesion: inxhinier

Gjithsejtë kompensimet 2014: 13,953 □ (Bruto) + Performanca e vitit 2013: 3,622.8 □ (Bruto)

1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual


Gjatë vitit 2014, performanca operative e KOSTT-it është mjaft e mirë dhe tregon përmirësime të vazhdueshëm. Janë bërë avansime në ngritjen e funksioneve operative në monitorimin dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative të Bllokut Rregullues.

Infrastruktura e matjeve komerciale ka përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes përdorimit të Fibre Optikut në pronësi të KOSTT-it.

Realizimi i planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave gjatë këtij viti ka qenë 92%, ndërsa i nënsatcioneve 97%.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera jashtë aktiviteteve të planifikuara, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operatorit të transmisionit.

Performanca financiare e KOSTT-it, edhe këtë vit është mjaft e mirë, dhe më detalisht është paraqitur në Pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Janë arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit për vitin 2014, kështuqë indikatorët kyç të performancës (IKP) operative dhe financiare janë pozitive. Këta parametra të performancës janë vlerësuar rregullisht nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT, dhe kanë qenë pjesë e Raporteve të rregullta tremujore, të cilat janë dorëzuar në Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.

1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it

Ngjarjet të cilat kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it paraqesin njëkohësisht edhe risqet me të cilat KOSTT-i ballafaqohet dhe që në mënyrë direkte afektojnë funksionimin e KOSTT-it.


Marrëveshja e firmosur për energji në mes të Kosovës dhe Serbisë ka qartësuar që KOSTT do të ketë përgjegjësitë për operim të pavarur duke filluar për afërsisht nga mesi i vitit 2015.

KOSTT është duke aplikuar në Asociacionet ndërkombëtare të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E), me të cilët operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila na mundëson ndër të tjera edhe pjesëmarrjen në mekanizmat e përbashkëta që valorizojnë çdo transaksion ndërkufitar. Valorizimi i aranzhmaneve ndërkufitare mund ti sjellë të hyra në dobi të KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës.

1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit gjatë vitit 2015, do të jenë:

- Fillimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese më vehte në përputhje me rregullat e ENTSO-E
- Çertifikimi i KOSTT si Operator i Sistemit të Transmisionit
- Implementimi i marrëveshjeve Ndër- OST me OST-të fqinje
- Zhvillimi i procedurave të tregut, konform Modelit dhe Rregullave të Tregut të energjisë elektrike në Kosovë
- Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Rregullave të Tregut .
- Investimi në platforma softuerike, rifreskimi i atyre ekzistuese, trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin e tyre. Platformat softuerike si SCADA/EMS, TI e Tregut, Kontrolla Frekuncë Fuqi-LFC, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- (Day Ahead Congestion Forecast), Softuer për mbikqyrje dhe kontroll në kohën reale, paisjeve të TL të tipit T5000, E-TERRA Habitat do

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

të mundësojnë dhe lehtësojnë kryerjen e aktiviteteteve e të gjitha palëve pjesmarrëse në tregun e energjisë përpër të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike.

- Eksploatimi maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese që më saktësisht konsiston në:
 - 1. Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit transmetues nga Qendra Nacionale Dispeçerike Kryesore dhe Emërgjente
 - 2. Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS
 - 3. Krijimi i kushteve teknike për monitorim të ndërsjell me OST-të fqinje në kohën reale
 - 4. Krijimi i infrastrukturës së domosdoshme teknike dhe legale për operim paralel në EH(Electronic Highway) të ENTSO-E.
 - 5. Krijimi i infrastrukturës së domosdoshme teknike për aderim në platformat regjionale, veqmas në ato të Qendrës Koordinative në SWISSGRID-it - Laufenburg
 - 6. Azhurnimi i kodeve teknike në përputhje me Kodet e operimit të ENTSO-e dhe rritja e bashkëpunimit rajonal, , në përputhje me Ligjin e ri të Energjisë Elektrike dhe ENTSO-E Network Codes

Në aspektin e operimit gjatë planit afatmesëm do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuncë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshoj regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në dy varianta:


- Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë,ose
- Operimi në një zonë të përbashkët në faza të mëvonshme.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë nga 01.01.2015 do të operoj si zonë e pavarur tregtare dhe Operatori i Tregut do ta operojë tregun e energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si një zonë tregtare në vete.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurtë me energji elektrike KOSTT, ZRrE, ERE dhe OST kanë diskutuar dhe analizuar idenë e bashkimit të dy tregjeve në një treg të përbashkët (një zonë tregtare). Tregu i përbashkët do të jepte sinjale të duhura për investime në kapacitete gjeneruese të reja dhe llojin tyre, për investime në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes si dhe nga tregu i përbashkët do të përfitonin konsumatorët nga të dy vendet .

Tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri gjithashtu do të mundësojë hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe do të krijonte kushte për një treg konkurrues.

Themelimi i një tregu të përbashkët për të gjitha afatet kohor është në harmoni me objektivat e BE dhe Komunitetit të Energjisë dhe kjo mund të konsiderohet si hap drejt integritimit në tregun regjional të EJJL.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 15 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

. Në veçanti KOSTT-i do të:

- Përcjellë zhvillimet në rajon rreth tregut të energjisë elektrike
- Përmbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Sigurojë që të gjitha kërkesat e operimit rajonal mund të përmbushen, posaçërisht standardet e ENTSO-E ;
- vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmisionit) fqinje;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal; dhe
- Kontribuoj në punën e CAO (Coordinated Auction Office) ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët.

KOSTT-i për sa i përket rrjetit të transmisionit përveç te transformatorët 110/35 dhe 110/10(20)kV të transferuara nga KEK-u, në pjesën tjetër ka zhvilluar infrastrukturën e nevojshme për të u përgjigjur kërkesave të kompanisë private të Furnizimit dhe Shpërndarjes.


Në rrethinën afariste ka ndikuar edhe kalimi i aseteve 110/35/10 kV dhe transformatorëve 220/35/10(20) dhe 110 kV, si dhe i fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK sh.a në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, të datës 03 Gusht 2011. Ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve të domosdoshme do të vazhdojë në mënyrë që të sigurohet furnizim stabil dhe i sigurtë me energji elektrike gjatë dimrit të vitit 2014/2015, pasi që investimet në këto nënstacione 110/x kV nga KEK nuk kanë qenë të mjaftueshme.

Fokusi i aktiviteteve investive gjatë vitit 2015 do të përfshijë:

- Ndërtimin e linjës 400kV Kosovë – Shqipëri së bashku me komponentën e LFC;
- Prokurimin dhe kontraktimin e dy projekteve madhore të financuara nga KfW dhe BERZH (zgjerimi i kapaciteve në rrjetin horizontal të transmisionit 400kV si dhe zgjerimi i kapaciteve në rrjetin vertikal 110/10(20) kV sëbashku me linjat furnizuese.

KOSTT deri më tani ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet dhe masat preventive të nevojshme në mënyrë që asetet e transferuara nga KEK, të kenë një siguri më të madhe të operimit. Njëkohësisht është dukë investuar në rehabilitimin e këtyre NS-ve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre. Qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që të sigurojë një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe sigurisë në sistemin elektroenergjetik. Kështu, përmes aktiviteteve të duhura në sistem është arritur të krijohet një stabilitet i qëndrueshëm në funksionimin normal të sistemit. Duke iu falënderuar kësaj, si dhe investimeve të shumëta, KOSTT ka kaluar nga mirëmbajtja emergjente në mirëmbajtje preventive.

Plani i mirëmbajtjes për vitin 2015 del nga plani pesë vjeçar i mirëmbajtjes dhe revidohet sipas nevojës për aktivitete preventive të identifikuar si rezultat i revente apo kontrollimeve gjatë vitit paraprak.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Prioritet i KOSTT mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat kanë filluar të zhvillohen në sistemet e avansuara, duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve , në mënyrë që të kursethet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për ta plotësuar përgjegjshmërinë nga aspekti social, KOSTT do të sigurojë se do të kujdeset për shëndetin e punëtorëve dhe do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe do të përgatiten projekte konkrete për mbrojtjen e shëndetit për punëtorët e saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka realizuar projektin e sigurimit shëndetësor suplementar, gjegjësisht sigurimin shëndetësor ndaras nga sigurimi shëndetësor shtetëror për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë, i cili do të vazhdojë edhe në vitin 2015. Në vitin 2015 gjithashtu pritet të fillojë implementimi i Ligjit për sigurimin shëndetësor i cili do të ketë implikime buxhetore në kompani.

Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbush objektiven strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv. Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve gjithashtu do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Poashtu, në përputhje me objektiven strategjike që të jetë punëdhënës atraktiv, KOSTT edhe më tutje do të vazhdojë me punën e suksesshme për krijimin e një ambienti për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe motivimin e tyre në arritjen e performancës së standardeve më të larta.

Gjatë vitit 2015 është planifikuar që të zgjerohen aktivitetet në shërbim të komunitetit i cili preket nga ndërtimi i projektit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri. Gjithashtu planifikohet që të vazhdohet me punën në drejtim të vizibilitetit të identitetit korporativ të kompanisë.

KOSTT do të përpiqet që ashtu si deri më sot, edhe gjatë vitetve në vijim, të sigurojë qëndrueshmërinë e vet financiare dhe të vazhdojë të funksionojë si një organizatë efektive dhe efikase e cila gjithnjë punon në përmirësimin e performancës së punës.


1.7. Infomacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (njëzetepesëmijë) Euro dhe është i ndarë në 25.000 aksione me vlerë nominale 1 Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është deklaruar dhe paguar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .

Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Struktura e kapitalit është paraqitur në tabelën vijuese:

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faje 17 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Fitimet e mbajtura	TOTALI
(në Euro 000)				
Bilanci më 1 Janar 2013	25	38,322	18,157	56,504
Neto fitimi për vitin 2013	-	-	3,557	3,557
Shpërndarja e dividendes	-	-	(3,000)	(3,000)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	14,850	-	14,851
Bilanci më 31 Dhjetor 2013	25	53,172	18,714	71,912
Bilanci më 1 Janar 2014	25	53,172	18,714	71,912
Neto fitimi për vitin 2014	-	-	4,371	4,371
Shpërndarja e dividendes	-	-	-	-
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2014	25	53,172	23,085	76,283

1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit

Në vitin 2014 në KOSTT investimet kapitale janë realizuar bazuar në Planin Zhvillimor dhe Planin Investiv 2014 -2018.

Viti 2014 ka qenë vit i realizimit të projekteve, të cilat kanë filluar vitet e mëherëshme, pra projekteve në vazhdimësi, përgaditja e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike për projektet e reja, startimi me implementim të projekteve të reja dhe ajo që karakterizohet si rezultat më i madh i vitit është përgaditja e specifikimeve teknike dhe tender dosjes për projektet “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit - Programi IV dhe V”, që janë bashkëfinansim KfW/KOSTT dhe KE (IPA programi). Specifikim Teknik dhe Tender dosja është përgaditur në bashkëpunim me kompaninë konsulente MVV Decon/Consulectra dhe pritet që viti 2015 të jetë vit i fillimit të implementimit të këtyre projekteve.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 18 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Departamenti për Menaxhim të Projekteve & Inxhinieri realizimin e obligimeve rreth investimeve të rëndësishme në vitin 2014 e ka kategorizuar në tri grupe:

I. Përgatitja e Specifikimeve Teknike për Projektet:


- Përgatitja e specifikimeve teknike dhe tender dosja dosjes për projektet "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit – Programi IV dhe V", që janë bashkëfinansim KfW/KOSTT dhe KE (IPA programi) / KfW dhe KOSTT . Specifikim Teknik dhe Tender dosja është përgaditur në bashkëpunim me kompaninë konsulentë "Consulectra" MVV Decon/Consulectra dhe pritet që viti 2015 të jetë vit i fillimit të implementimit të këtyre projekteve . Furnizimi dhe instalimi i Transformatorit të dytë, 300 MVA në NS Ferizaj 2 dhe NS Peja 3;
 - Ndërrimi i përçusve mbrojtës me OPGW në linjat interkonektive 400kV, 220kV dhe 110 kV;
 - Ndërrimi i ndërprerësve të fuqisë në NS 220/110kV Prishtina 4;
 - Rehabilitimi i Linjes 110 kV, NS Peja 2 – NS Decan (14.6 km);
 - Linja e re 110 kV NS Peja 3- NS Peja 1 (30km) dhe ri-vitalizimi i NS Peja 1& Furnizimi dhe instalimi i stabilimenteve të reja 110 kV (Gas Insulated Switchgear – GIS) në NS Peja 1, që përfshin ndërrimin e atyre konvencionale (AIS);
1. Instalimi i kabllit mbrojtës Optik OPGW në linjën interkonektive Kosovë – Mali i Zi ;
 2. Instalimi i kabllit mbrojtës Optik OPGW në linjën interkonektive Kosovë – Sërbi LP 205;
 3. Instalimi i Mbrojtkeve rele në fushat transformatorike në KOS A ;
 4. Instalimi i TR2 në NS 110/10kV Berivojcë dhe Viti

II. Menaxhimi i projekteve, të cilat janë implementuar ose janë në afat garantues :

1. Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-1:SCADA/EMS;
2. Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-2: Telekom;
3. Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2);
4. Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1;
5. Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2;
6. Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj;
7. Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo


III. Menaxhimi i projekteve, projektet të cilat kanë filluar me implementim në vitet e mëherëshme (në vazhdimësi) dhe projektet, që kanë filluar me implementim në vitin 2014:

8. Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1;
9. Shërbimet konsulentë & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2;
10. Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

11. Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1-Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i Pajisjeve të TL në NS Gjakova 1;
12. Revitalizimi i nënstacioneve NS 110kV , ana 35kV në NS Gjakova 1;
13. Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos B;
14. Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos A
15. Instalimi i TR 2 ne NS 110/10(20) - Skenderaj dhe instalimi i TR në NS Burim;
16. Instalimi i transformatorit të tretë në NS 110/10(20) kV Prishtina 2;
17. Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispečerike dhe në Qendrën Emergjente Dispečerike;
18. Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH;
19. Instalimi i TR 3 dhe pajisjeve të tensionit të lartë në NS Deçani :
 - *Bazuar në Marrëveshjen për Kyçje KOSTT / KelKos për kyçjen e Gjeneratorëve me ujë në rrjetin e Transmisionit; Investues KelKOS . Pas kalimit të afatit garantues asete e TL kalojnë në5 pronësi të transmisionit .*

Viti 2014 karakterizohet edhe me takime të shumta me KEDS rreth arritjes së marrëveshjeve për financim në projektet e përkrahjes së ngarkesës, përgaditja e Marrëveshjeve të Kyçjes, që pritet të finalizohen në fillim të vitit 2015 .

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 20 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

2.1. Arritjet kryesore

Që nga themelimi, KOSTT-i ka shënuar një progres substancial si organizatë e qëndrueshme dhe efektive. Është zhvilluar struktura organizative, ka marr licencat për Operator të Sistemit të Transmisionit dhe për Operator të Tregut; është zhvilluar infrastruktura e operimit të sistemit dhe tregut, janë zhvilluar dhe shumë nga kodet e domosdoshme teknike dhe rregullat e tregut dhe do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen. Megjithatë, tani është me rëndësi për KOSTT-in që të përgatitet për sfidat e reja me të cilat do të përballet në të ardhmen. Një vend të rëndësishëm në këtë drejtim zënë zhvillimet e tregut në Kosovë dhe rajon dhe një ndër objektivat e saj strategjike është edhe integrimi rajonal dhe arritja sa më e shpejtë e anëtarësimi në ENTSO-E.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit, padyshim është në mesin e detyrave të KOSTT dhe është në përputhje me objektivat e saj strategjike. Sa i përket përmbushjes së kësaj detyre, performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2014, ka pasur ngritje të theksuar.


Linjat dhe nënstacionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, duke realizuar 92% të planit për mirëmbajtjen e linjave dhe 97% të planit për mirëmbajtjen e nënstacioneve. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i linjave dhe nënstacioneve, remontet e linjave dhe transformatorëve, shqyrtimi i rregullt i fushave, shqyrtimet e mbrojtjeve rele, si dhe aktivitete tjera jashtë aktiviteteve të planifikuara të mirëmbajtjes, atëherë kur për këtë është paraqitur nevoja.

Përveç kësaj, janë zhvilluar me sukses negocijimet me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (EBRD) për kreditim për projektet për Përkrahjen e Ngarkesës, dhe në bashkëpunim me MMPH, arritja e shpronësimit të tokave për segmentin e parë të LP 400kV Kosovë – Shqipëri dhe fillimi i punëve në këtë segment.

Implementimi i suksesshëm i projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në rradhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Procesi i Nominimit Dry-Run i programeve ditore nga palët sipas metodologjisë ESS(ENTSO-E Scheduling System) përmes IT për Treg i filluar në Maj të 2013 ka vazhduar pa ndonjë problem sa i përket nominimit të palëve brenda zonës tregtare të KOSTT.

Pas miratimit të Rregullave të Tregut është vazhduar puna në finalizim e Procedurave të Rregullave të Tregut për alokimin e energjisë së matur, korigjimin e matjeve, garacionin financiar dhe leximin, përafrimin dhe validimin e të dhënave matëse, të cilat janë dorëzuar në ZRRë. Poashtu, gjatë tërë vitit, janë dërguar në afatin e paraparë raportet e

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

rregullta dhe sipas kërkesave të ZRRrE, si dhe janë përgatitur dokumentet lidhur me procesin e monitorimit.

Opinionit i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2013, i cili është pa asnjë kualifikim, dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimi të të gjitha resurseve. Poashtu, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Janë aprovuar shumë dokumente të rëndësishme, politika dhe procedura në harmoni me dispozitat e Ligjit të Punës.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2014, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2014.

2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

2.2.1. Tremujori i parë

1. Vizita e ambasadorit të Norvegjisë në KOSTT

Në janar ambasadori e Norvegjisë në Kosovë z.Jan Braathu me bashkëpunëtorë ka vizituar KOSTT. Në kuadër të takimit u diskutua për projektin e planifikuar për bashkimin e tregut energjetik Kosovë-Shqipëri dhe benefitet që rrjedhin nga ky projekt për të dyja sistemet energjetike. Për më tepër realizimi i këtij projekti ndër të tjera do të krijojë kushte më të favorshme për të dy vendet për integrim të mëtutjeshëm në tregun rajonal të energjisë. z.Braathu u zotua që shteti i Norvegjisë do të përkrahë financiarisht projektin për krijimin e tregut të përbashkët energjetik Kosovë-Shqipëri.

2. Misioni i BERZH për projektet investive


Në kuadër të vizitës BERZH ka bërë vlerësimin teknik të projekteve të cilat janë propozuar për financim. Konstatimi i BERZH është se të dhënat e ofruara janë të mjaftueshme për të vazhduar shqyrtimin dhe përgatitjen e propozimit për miratim fillestar nga BERZH.

3. Marrëveshja kornizë EMS (Serbi)

Në bazë të Marrëveshjes për energji të nënshkruar ndërmjet Kryeministrit të Kosovës dhe Kryeministrit të Serbisë, është nënshkruar marrëveshja kornizë ndërmjet EMS dhe KOSTT teksti i së cilës është harmonizuar paraprakisht nga EMS dhe KOSTT dhe për të cilën nivelet politike të Kosovës dhe Serbisë kanë dhënë pëlqimin. Tani pritet që të vazhdohet hartimi i marrëveshjes së plotë për operim.

4. Implementimi i projektit të linjës 400kV Kosovë – Shqipëri

Sa i përket implementimit të projektit të linjës 400kV Kosovë – Shqipëri vazhdojnë përgatitjet për implementimin e projektit. për Lot 2 është bërë pagesa e avansit, ndërsa për Lot 1 janë kryer verifikimet dhe pritet që bëhet autorizimi i pagesës.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 22 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.2.2. Tremujori i dytë

1. Pjesëmarrja në panelin e Bankës Evropiane për Investime

Pjesëmarrja në prezantimin e Bankës Evropiane për Investime si panelist për prezantimin rreth projekteve investive të KOSTT si dhe përvojën e KOSTT në përthithjen e investimeve, apo huave për projekte kapitale.

2. Pjesëmarrja në ceremoninë për nënshkrimin e MeM për tregun e përbashkët KOSTT ka marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit për themelimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri, të nënshkruar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik e Kosovës dhe Ministri i Industrisë dhe Energjisë së Shqipërisë.

3. Prezantimi i studimit për integrimin e burimeve me erë në operimin e sistemit

Është mbajtur prezantimi publik i studimit për integrimin e burimeve me erë në operimin e sistemit ku janë paraqitur ndikimit dhe parakushtet për integrimin e këtyre burime në operimin e SEE. Ky studim është financuar nga BERZH.

4. Projekti i linjës 400kV Kosovë-Shqipëri

Vazhdimi i implementimit të projektit Kosovë-Shqipëri. Projekti i është i ndarë në dy pjesë Lot 1 - Linja 400kV dhe Lot 2 Rregullimi Frekuencë fuqi dhe fusha e linjës në NS Kosova B. Sa i përket Lot 1 procesi i shpronësimit është në vazhdim e sipër, pra është përgatitur dhe dorëzuar elaborati i shpronësimit për segmentin e parë, dhe aktualisht janë duke u mbajtur dëgjimet publike, gjithashtu edhe procesi për garancionin ECA është në vazhdim e sipër. Ndërsa Lot 2 nuk ka filluar ende për arsye të vonësës së pagesës së avansit nga ana e Shqipërisë.

5. Pjesëmarrja në konferencën për tregun e përbashkët Kosovë-Shqipëri


KOSTT ka marrë pjesë në konferencën e përbashkët të organizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës dhe Ministria e Energjisë së Shqipërisë për investimet në sektorin publik dhe krijimin e tregut të përbashkët.

6. Projekti i linjës 400kV Kosovë-Shqipëri

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për shpronësimin e segmentit të parë të trasesë së linjës 400kV Kosovë – Shqipëri, dhe pritet që tani të vazhdohet me faza tjera të projektit. Ndërsa sa i përket Lot 2 të projektit, tani kontrata ka hyrë në fuqi pasi që pala shqiptare ka realizuar pagesën e avansit.

2.2.3. Tremujori i tretë

1. Marrëveshja ndërmjet OST-ve respektivisht me EMS

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Janë harmonizuar marrëveshjet (marrëveshja ndër OST dhe marrëveshja për shërbime ndihmëse) me EMS, kemi marrë pëlqimin për nënshkrim të marrëveshjes, dhe e njëjta është nënshkruar nga ana e KOSTT, dhe e njëjta është përcjellë në SKE. Deri më tani EMS nuk ka marrë hapa për nënshkrim, por ka kërkuar garancione për furnizim në pjesën veriore të Kosovës, gjë për të cilën Qeveria është zotuar se do të ketë furnizim stabil.

2. Aksidenti në TC Kosova A

Pas aksidentit në TC Kosova A është shtruar nevoja që të mendohet për furnizim gjatë periudhës së dimrit. Lidhur me situatën e krijuar KOSTT është mandatuar nga MZHE që të thërras takimin e task forcës dhe të hartoj skenarët për furnizim. Në ndërkohë A 3 është kthyer në punë, A5 dhe A4 do të mund të shkojnë në remont. Gjatë kësaj periudhe deri në rikthimin në operim të njësive tjera të Kosovës A do të paraqiten kosto të shtuara për importe.

3. Negociatat me BERZH

KOSTT ka zhvilluar negociatat me BERZH për kredi investive në vlerë prej 30 milion, e cila është miratuar nga Bordi i BERZH. Projektet e propozuara i shërbejnë ngarkesës, dhe janë të përqendruara në pjesët më të pazhvilluara në Kosovë. Këto janë kryesisht nënstacione dhe disa linja të ndërlidhura. Gjithashtu janë mbajtur takime me KfW për financimin për Fazën VI-VII. KfW gjithashtu do të ofroj një grant për rehabilitimin e NS Vallaçai në pjesën veriore të Kosovës.

2.2.4. Tremujori i katërt


1. Marrëveshja e Operimit me EMS

Me 23 shtator është nënshkruar marrëveshja operative me EMS, sipas së cilës KOSTT do të operoj si zonë kontrolluese e pavarur. Kjo marrëveshje përcakton një periudhë kalimtare e cila fillimisht është e parashikuar të përfundoj me 31 dhejtor 2014 dhe operimi i pavarur do të filloj me 1 janar 2015, por për arsye të vonësave në procesin e nënshkrimit tani periudha kalimtare me gjasë do të zgjatet, dhe pritet që operimi i pavarur të ofroj nga data 1 mars 2015. Gjatë kësaj kohe KOSTT ka nënshkruar edhe një marrëveshje tjetër, për shërbimet e balancimit me EMS, për të cilën është diskutuar edhe me rregullatorin, dhe të cilën rregullatori e ka miratuar. Lidhur me këto si aktivitet pasues është mbajtur takimi me EMS për çështjet implementuese dhe afatet, përkatësisht harmonizimin e afateve për punët e përbashkëta.

2. Marrëveshja për kredi me BERZH

Me datë 15 tetor pas dhënies së pëlqimit nga Aksionari lidhur me dispozitat e marrëveshjes të cilat janë në përgjegjësi të aksionarit KOSTT ka nënshkruar marrëveshjen për kredi me BERZH.

Me këtë marrëveshje përcaktohet që KOSTT do të përfitoj një grant prej 2 milion euro, nga të cilat 1.2 milion do të kanalizohen si asistencë teknike dhe pjesa tjetër do të jetë mbështetje për procesin e përgatitjes dhe tenderimit të projekteve të financuara në kuadër të kredisë.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 24 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

3. Konferenca për Energji në Kosovë

KOSTT ka marrë pjesë në konferencën për energji të organizuar nga Evroenergie në kuadër të javës së bashkëpunimit Kosovë-Gjerman e mbajtur në Prishtinë lidhur me tregun regional, dhe funksionalizimin e tij.

4. Takimi me ENTSO-E


Me date 23 tetor 2014 është mbajtur një takim katërpalësh KOSTT, EMS, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ENTSO-E në të cilin është diskutuar për implementimin e marrëveshjes operative KOSTT-EMS. Gjatë takimit diskutimi është përqendruar në çështjen e alokimit të kapaciteteve dhe përfshirjes së KOSTT në ITC. Lidhur me alokimin e kapaciteteve është theksuar se parakusht për alokim është realizimi i skedulimit dhe barazimit, e cila gjithashtu lidhet me marrjen përsipër të funksionimit si zone e pavarur kontrolluese. Përfaqësuesit e ENTSO-E theksuan se funksionalizimi i operimit si zone kontrolluese mund të bëhet vetëm pas vlerësimit i cili do të kryhet nga Grupi i Projektit për KOSTT i themeluar në kuadër të ENTSO-E, duke marrë këtë parasysh u theksua se afati me optimal do të jete 1 mars 2015. Ndërsa deri në kohën kur KOSTT të filloj operimin e zonës e pavarur u propozua që alokimi i kapaciteteve të bëhet në baza mujore nga EMS, dhe të hiqet dorë nga alokimi vjetor.


Ndërsa sa i përket ITC nga përfaqësuesit e ENTSO-E u theksua se përfshirja e KOSTT si palë e pavarur në marrëveshje realisht mund të ndodh nga data 1 korrik 2015.

Ekspertët e KOSTT janë të angazhuar vazhdimisht për të plotësuar pyetëtorin për pajtueshmërinë me kërkesat e Doracakut Operativ me ENTSO-E, i cili do të dorëzohet për vlerësim nga Grupi i Projektit për KOSTT.

5. Tryeza e punës e organizuar nga ZRRë -NARUC

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet ZRRë dhe NARUC (asociacioni i rregullatorëve të SHBA) është mbajtur një tryezë pune e organizuar nga ZRRë ku KOSTT ka prezantuar propozimi për tregun e përbashkët Kosovë - Shqipëri me qëllim të sensibilizimit dhe promovimit të këtij projekti.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

2.3.1 Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2014


Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2014		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	1 311 326	1 508 885	115.07
(2) TC Kosova B	3 595 946	3 349 065	93.13
(3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B)			
(4) HC Ujmani	82 000	101 517	123.80
(5) HC Lumbardhi	26 136	31 679	121.21
* (6) = 1+2+3+4 Prodhimi në hyrje të transmisionit	4 989 272	4 959 467	99.40
(7) Devijimi		- 14 100	
(8) Eksporti	310 758	474 791	152.78
(9) Importi	895 733	965 633	107.80
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim	5 574 247	5 464 410	98.03
(11) Distribucioni	4 559 561	4 369 274	95.83
(12) Ferronikeli	526 680	537 438	102.04
(13) Sharri	63 270	61 468	97.15
(14) Trepça	27 114	24 464	90.23
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK	138 000	129 659	93.96
(16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	145 121	233 272	160.74
(17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto	5 459 746	5 355 575	98.09
(18) Humbjet në transmission	114 501	108 835	95.05
(19) =17+18 Kërkesa gjithsej	5 574 247	5 464 410	98.03

(3) Energjia për shpenzime vetanake nga (TC A dhe TC B) e cila hyn në rrjetin e transmisionit është e barabartë me energjinë që termocentralet e marrin nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetanake (16). Rreshti (3) në tabelë në vlerat e realizuara është e përfshirë në pikën (6)- Prodhimi në hyrje të transmisionit.

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2014 versioni i rishikuar (për shkak të ndodhisë në TC Kosova A).

Të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

*Notë; Bilanci energjetik është aprovu pas aprovimit të buxhetit të reviduar.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>



RAPORT VJETOR


ver. 1.0

DT-FI-010


faqe 28 nga 76

Departamenti Financiar

Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti




Diagrami i balancës të realizuar elektroenergjetike Janar-Dhjetor 2014 (GWh)



2.3.2 Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr	Indikator	Janar-Dhjetor 2013	Janar-Dhjetor 2014	2014/2013(%)	Caku	Komenti
T1	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)					I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSE-E
T2	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC					I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSE-E
T3	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhen e raportimit)	670.79	129.35	19.28	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen aktuale)/(AIT për periudhen e kaluar) <sub>1	AIT ka qenë më e madhe gjatë periudhes Janar-Dhjetor 2013, por një pjesë e madhe e energjisë së pafurnizuar kanë qenë me plan, për shkak të punëve gjatë implementimit të projekteve
T4	Numri i ankesave për tension	3	3	100	Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlihet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurrtë.

	RAPORT VJETOR		DT-FI-010
	ver. 1.0		faqe 31 nga 76
Departamenti Financiar		Sektor: Planifikimi, Strategjik dhe Buxheti	

T5	Numri i ankesave për matje	0	0	0		
T6	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	28.94	22.46	77.63	30MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		30.25	20.39	67.40	30MWh/h shtyesje jashta programit të deklaruar	Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 1,36 % më të ulta në periudhën Janar-Dhjetor 2014 se sa në periudhën e njëjtte 2013.
T7	Humbjet në transmision (GWh)	110.34	108.83	98.64		

AATC-Average Available Transmission Capacity

MATC-Maximum Available Transmission Capacity

$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$

ENS-Energy not supplied - EPP-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve (minuta/periudha e raportimit)



Departamenti Financiar

RAPORT VJETOR

ver. 1.0

DT-FI-010

fajqe 33 nga 76

Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

	110/35/10	1.28	9.52	7.4375	
T6	Koha mesatare e shkytyjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.266666667	0	0
		220/110	0.166666667	0	<1
		110/35/10	0	8.94	0
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	6.668333333	0	0
		220	10.27666667	0	<1
		110	9.723333333	0	0
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	2.541666667	0	0
		220	2.920833333	0	<1
		110	5.064083333	0	0
T9	Koha mesatare e shkytyjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0	0	0
		220	0	0	<1
		110	1.057	0	0
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	5	0	0
		220	3.896666667	0	<1
		110	2.25	1.18	0.524444444
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	1.395	0	0
		220	2.604166667	0	>1
		110	1.931666667	6.4	3.313201035
T12	Koha mesatare shkytyjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0	0	0
		220	0	0	<1
		110	0	727.2	0

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 34 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.4. Operimi i tregut

2.3.4 Raport mbi operimin e tregut

2.3.4.1 Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë të pavarur dhe në bazë të ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Feronikeli furnizohet nga KEDS me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet si raport i energjisë së konsumuar në nivelin 220kV në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë e shprehur në diagramet më poshtë.



Në krahasim me vitin 2013 në vitin 2014 kemi zvogëlim të humbjeve nga 110.337MWh në 108.831MWh e që e shprehur në përqindje është 1.81%.

Tranziti i energjisë elektike në periudhën Janar-Dhjetor' 14 në rrjetin e KOSTT ka qenë 2.288.206 MWh gjegjësisht 28% e rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues. Edhe më tutje KOSTT nuk kompensohet për këtë shërbim nga mekanizmi i ITC por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).

Sipas vlerësimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në vitin 2014 është mesatarisht 1.45% e konsumit vendor, nga 0.75% sa ishte në vitin 2013.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në vitin 2014, i furnizuar nga rrjeti 110kV, ka qenë 4.486.885MWh apo 83% i konsumit total ta dalë nga rrjeti transmetues që ishte 5.466.612MWh.


Tregu i rregulluar dhe pa-rregulluar




Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues dhe

Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues
humbjet në transmision

Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 36 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Të arriturat, pengesat(dështimet) dhe sugjerimet e departamenteve


Operatori i Tregut Janar-Dhjetor 2014

- Pas miratimit të Rregullave të Tregut është vazhduar puna në finalizim e Procedurave të Rregullave të Tregut për:
 - Alokimin e Energjisë së Matur
 - Korrigjimin e Matjeve
 - Garacionin financiar
 - Leximin përafrimin dhe validimin e te dhënave matëse

Këto procedura janë dorëzuar në ZRRë për miratim me datën 19.06.2014 dhe janë komentuar nga ana e ZRRë.

Pas rishqyrtimit të komenteve nga ana e Opertaorit të Tregut është dërguar versioni i reviduar te ZRRë për miratim. Pritet që miratimi i tyre të bëhet në fillim të vitit 2015

- Lëshimi i kodit KOSTT si zonë tregtare/rregulluese e cili do të funksionalizohet menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes mes KOSTT dhe EMS. ky kod do ti mundësoj KOSTT të operoj zi zonë tregtare dhe zonë rregulluese e pavarur.
- Në përmbushjen e objektivave të KOSTT një nga të cilat është edhe integrimi rajonal, Operatori i Tregut ka vazhduar aktivitetin në arritjen e marrëveshjes operative mes KOSTT dhe EMS. Pas nënshkrimit të marrëveshjes me EMS, Operatori i Tregut ka marrë pjesë aktive në arritjen e marrëveshjeve me TSOtë fqinje si OST, MEPSO dhe CGES
- Pas arritjes së marrëveshjes me EMS, Operatori i Tregut nga data 15 tetor 2015 ka filluar realizimi i Procesit të Nominimit të programeve ditore nga palët sipas metodologjisë ESS(ENTSO-E Scheduling System) përmes IT për Treg.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 37 nga 76
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti


2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet

Në vazhdim, janë paraqitur Draft Pasqyrat Financiare

Bilanci i Gjendjes

31.12.2014

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues-2014	Viti i kaluar-2013
	PASURITË			
A	KAPITALI I THIRRUR I PAPAGUAR			
B	PASURITË JOQARKULLUESE (I+II+III+IV)		130,538,116	126,871,149
I	PASURITË E PAPREKSHME (1 deri 4)		16,416,981	6,886,028
1	Kostot e zhvillimit		15,137,020	5,191,117
2	Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera	5	1,279,961	1,694,911
3	Emri i mirë (Goodwilli)			
4	Pasuritë tjera të paprekshme			
II	PASURITË E PREKSHME (1 deri 7)		114,121,135	119,985,121
1	Toka	4	2,638,628	2,304,525
2	Objektet ndërtimore	4	11,562,243	10,637,469
3	Pajisjet dhe makineritë	4	65,732,528	71,025,593
4	Veglat, inventari i reparit dhe mjetet transportuese	4	1,601,281	1,887,484
5	Pasuritë biologjike			
6	Pasuritë tjera të prekshme- Rrjeti I transmisionit(lloji I	4	32,586,455	34,130,050
7	Investimet në patundshmëri	4		
III	PASURITË FINANCIARE JOQARKULLUESE (1 deri 6)		-	-
1	Aksionet tek filialat			
2	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3	Investimet në ortakëri			
4	Investimet në letra me vlerë			
5	Huatë e dhëna, depozitat dhe të ngjashme			
6	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
IV	PASURITË E SHTYRA TATIMORE			
C	PASURITË QARKULLUESE (I+II+III+IV)		37,239,192	30,072,997
I	STOQET (1 deri 5)		2,603,983	2,594,486
1.	Lënda e parë dhe materiali	6	2,603,983	2,594,486
2.	Prodhimtaria në vijim			
3.	Produktet e gatshme			
4.	Mallrat e listuara në bursë			
5.	Pasuritë tjera qarkulluese për shitje			
II	LLOGARITË E ARKËTUESHME (1 deri 6)		2,928,569	5,971,258
1.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialat			
2.	Llogaritë e arkëtueshme tregtare	7	2,928,569	5,971,258
3.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialet			
4.	Llogaritë e arkëtueshme nga punëtorët			
5.	Llogaritë e arkëtueshme nga shteti dhe institucionet			
6.	Llogaritë tjera të arkëtueshme	8		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 38 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

III	PASURITË FINANCIARE QARKULLUESE (1 deri 6)		8,198,891	-
1.	Aksionet tek filialat			
2.	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3.	Investimet në ortakëri			
4.	Investimet në letra me vlerë			
5.	Huatë e dhëna, depozitat dhe të ngjashme	9	8,198,891	
6.	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
IV	PARATË NË BANKË DHE ARKË		23,507,749	21,507,253
E	GJITHSEJT PASURITË (A+B+C+D+E)		167,777,308	156,944,146
F	ZËRAT JASHTËBILANCORË			
	EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET			
A	EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT		158,850,314	149,811,336
I	KAPITALI THEMELUES (I REGJISTRUAR)			
II	KAPITALI REZERVË-THEMELUES	10	25,000	25,000
III	REZERVAT NGA FITIMI (1 deri 4)		135,740,312	131,072,010
1.	Rezervat ligjore			
2.	Rezerva për aksionet vetjake			
3.	Rezervat statutore	11	53,322,442	53,172,442
4.	Rezervat tjera	12	82,417,871	77,899,568
IV	REZERVAT E RIVLERËSIMIT			
V	FITIMET/HUMBJET E BARTURA		18,714,326	15,157,478
VI	FITIMI APO HUMBIA E VITIT FINANCIAR		4,370,676	3,556,848
VII	INTERESI MINORITAR			
B	DETYRIMET AFATGJATA (1 deri 8)		-	-
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare			
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme			
8	Detyrimet e shtyra tatimore			
C	DETYRIMET AFATSHKURTA (1 deri 11)		8,926,994	7,132,810
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare			
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme	13	8,484,521	6,763,674
8	Obligimet ndaj të punësuarëve		317,799	261,687
9	Obligimet për tatime dhe kontribute		124,674	107,449
10	Obligimet ndaj aksionarëve për dividenda			
11	Obligimet tjera afatshkurta			
D	GJITHSEJ EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET (A+B+C+D)		167,777,308	156,944,146


RAPORT VJETOR

ver. 1.0

DT-FI-010

faqe 39 nga 76


Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

DRAFT PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBYES

Për periudhën 01.01.14 deri 31.12.14

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shëni mit	Shumat në euro				% e realizimit 2014 ndaj planifikimit 2014
			Realizimi Viti vijues-2014	Realizimi Viti i Kaluar-2013	% e realizimit 2014/2013	Planifikimi 2014	
I	TE HYRAT (1 deri 3)		25,283,169	24,007,141	105%	25,879,955	98%
1	Të hyrat nga shitja-sherbimet		18,845,411	17,684,655	107%	19,214,955	98%
	Të hyrat nga sherbimet tjera.		39,253	135,936	29%	30,000	131%
3	Të hyrat tjera afariste		6,398,506	6,186,550	103%	6,635,000	96%
II	SHPENZIMET (1 deri 7)		20,928,944	20,486,827	102%	22,011,922	95%
1	Zvogëlimi i vlerës së stoqeve						
2	Rritja e vlerës së stoqeve						
3	Shpenzimet e materialit (a+b+c)		195,923	142,769	137%	183,000	107%
	a) Materiali dhe lënda e parë		195,923	142,769	137%	183,000	107%
	b) Shpenzimet e mallit të shitur						
	c) Shpenzimet tjera						
4	Shpenzimet e pagave (a+b)						
	a) Pagat dhe meditet bruto	16	4,776,577	4,217,097	113%	4,719,429	101%
	b) Kontributi për sig.pens/Punëdhënës	16	237,553	241,317	98%	236,533	100%
5	Zhvlerësimi	4	10,051,108	9,546,578	105%	10,206,000	98%
6	Shpenzimet tjera		3,062,830	3,426,993	89%	3,214,590	95%
7	Shpenzimet tjera afariste	17, 18	2,409,030	2,769,304	87%	3,269,370	74%
III	TE ARDHURAT FINANCIARE (1 deri 5)		480,613	604,234	80%	0	0%
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialat		480,613	604,234	80%	0	0%
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët						
3	Piesa e të hyrave nga filialat						
4	Fitimi i përealizuar						
5	Të ardhurat tjera financiare						
IV	TË DALAT FINANCIARE (1 deri 4)		0	-		0	
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialat						
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët						
3	Humbja e përealizuar						
4	Të dalat tjera financiare						
V	Të ardhurat tjera të pazakonshme						
VI	Të dalat tjera të pazakonshme						
VII	GJITHSEJ TË ARDHURAT (I+III+V)		25,763,783	24,611,375	105%	25,879,955	100%
VIII	GJITHSEJ SHPENZIMET (II+IV+VI)		20,928,944	20,486,827	102%	22,011,922	95%
IX	FITIMI PARA TATIMIT (VII-VIII)		4,834,838	4,124,548	117%	3,868,033	125%
X	HUMBJA PARA TATIMIT (VIII-VII)		4,834,838	4,124,548	117%	3,868,033	125%
XI	TATIMI NË FITIM		660,086	710,469	93%		
XII	FITIMI NETO (IX-XI)		4,174,753	3,414,079	122%	3,868,033	108%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Draft Pasqyra e të Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues-2014	Viti i kaluar-2013
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE				
1	Fitimi para tatimit		4,370,675.62	4,267,317.00
2	Zhvlerësimi		10,051,107.65	9,546,577.68
3	Rritja e detyrimeve afatshkurta		1,829,102.32	-1,534,065.94
4	Zvogëlimi i kërkesave afatshkurta		741,120.63	121,989.89
5	Zvogëlimi i sto-te hyrat e shtyra		-6,398,505.92	-6,186,549.96
I	Rritja e përgjithshme e rrjedhës së parasë nga aktivitetet operative (1 deri 5)		10,593,500.30	6,215,268.67
1	Zvogëlimi i detyrimeve afatshkurta		-480,612.90	
2	Rritja e kërkesave afatshkurta-avans		-5,897,322.41	8,091,000.00
3	Rritja e stoqeve		-9,496.33	-756,290.04
II	Zvogëlimi i përgjithshëm i rrjedhës së parasë nga aktivitetet operative (1 deri 3)		-6,387,431.64	7,334,709.96
A	RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (I-II)		4,206,068.66	13,549,978.63
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE				
1	Arkëtimet e parasë nga shitja e pasurive joqarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme			
2	Arkëtimet e parasë nga shitja e pronës dhe instrumenteve të borxhit			
3	Arkëtimet e parasë nga interesi		480,612.90	604,234.20
4	Arkëtimet e parasë nga dividendat			
5	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet investuese			
III	GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 5)		480,612.90	604,234.20
1.	Pagesat e parasë për blerjen e pasurive joqarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme		-7,853,467.95	-7,709,000.00
2.	Pagesat e parasë për blerjen e pronës dhe instrumenteve të borxhit		11,901,778.98	
3.	Pagesa tjera të parasë për		-6,734,496.30	



RAPORT VJETOR

DT-FI-010


ver. 1.0

faqe 41 nga 76

Departamenti Financiar


Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

	aktivitetet investuese			
IV	GJITHSEJ PAGESAT E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 3)		-2,686,185.27	-7,709,000.00
B	RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (III-IV)		-2,205,572.37	-7,104,765.80
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUESE				
1.	Arkëtimet e parasë nga emetimi e instrumenteve financiare të borxhit dhe atyre të ekuitetit			
2.	Arkëtimet e parasë nga kryegjeja e kredisë, fleteobligacionet, huatë dhe huazimet tjera			
3.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet financuese			
V	GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUESE (1 deri 3)		0.00	0.00
1.	Pagesat e parasë për pagimin e kryegjësë së kredisë dhe fletëobligacioneve			
2.	Pagesat e parasë për dividendat			-3,000,000.00
3.	Pagesat e parasë për lizingun financiar			
4.	Pagesat e parasë për ri-blerjen e aksioneve vetjake të kompanisë			
5.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet financuese			
VI	GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET FINANCUESE (1 deri 5)		0.00	-3,000,000.00
C	RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUESE (V-VI)		0.00	-3,000,000.00
D	RRJEDHA NETO E PARASË (A+B+C)		2,000,496.29	3,445,212.83
E	PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FILLIM TE PERIUdhËS		21,507,253.13	18,062,040.30
F	PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TË PERIUdhËS (D+E)		23,507,749.42	21,507,253.13

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Fitimet e mbajtura	TOTALI
(në Euro 000)				
Bilanci më 1 Janar 2013	25	38,322	18,157	56,504
Neto fitimi për vitin 2013	-	-	3,557	3,557
Shpërndarja e dividendes	-	-	(3,000)	(3,000)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	14,850	-	14,851
Bilanci më 31 Dhjetor 2013	25	53,172	18,714	71,912
Bilanci më 1 Janar 2014	25	53,172	18,714	71,912
Neto fitimi për vitin 2014	-	-	4,371	4,371
Shpërndarja e dividendes	-	-	-	-
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2014	25	53,172	23,085	76,283

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Informacionet për vitin financiar 2014

Të hyrat operative gjatë vitit 2014 kanë qenë 25,763 mijë euro dhe janë për 4.7% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet operative janë realizuar në vlerën prej 21,393 mijë euro dhe janë për 1.4 % më të larta në krahasim me vitin e kaluar.

Të hyrat e realizuara nga tarifa janë në vlerë prej 18,845 mijë euro dhe janë për 6.6% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa të hyrat tjera operative në vlerë prej 6,918 mijë euro janë për 0.18% më të ulta se në vitin 2013.

Fitimi para tatimit për vitin 2014 është në vlerë 5,031 mijë euro, dhe pas tatimit (fitimi neto) 4,371 mijë euro.


Asetet joqarkulluese janë në vlerën prej 130,538 mijë euro, pasuritë qarkulluese 37,239 mijë euro dhe gjithësejt pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2014 është në vlerën 167,777 mijë euro.

Kapitali akcionar dhe rezervat janë në vlerën prej 76,283 mijë euro, detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyera) 82,418 mijë euro dhe detyrimet afatshkurtëra 8,927 mijë euro.

Nga të dhënat e prezantuara, shihet se pasuria e KOSTT është financuar nga:

- 45.8% kapitali i akcionarit
- 49.6% grante qeveritare dhe grante tjera
- 5.0% detyrime afatshkurtëra


Struktura e kapitalit nuk ka ndryshuar dhe është e rritur vetëm për vlerën e fitimeve të mbajtura.

	RAPORT VJETOR		DT-FI-010
	ver. 1.0		faqe 44 nga 76
Departamenti Financiar			Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2014.

Treguesit	I-XII 2013	I-XII 2014	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto /gjithejtë të hyrat	0.15	0.20	Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese. Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.
T2. Treguesi i likuiditetit = kapitali punues/detyrimet qarkulluese	4.22	4.48	Përcakton aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj afat shkurta. Sa më e lartë është vlera e këtij treguesi, aq më e lartë është siguria që kompania posedon mjete për të mbuluar borxhet afatshkurta. Treguesi duhet të jetë më i madh se 1.
T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave=kërkesat *365 ditë/të hyrat	31	29	Ky tregues është i matshëm në baza vjetore Caku: <input type="checkbox"/> 90 dite
T4. Treguesi i efektit të kapitalit të investuar (ROCE) = fitimi netot/mesatarja e kapitalit të investuar mesatarja e kapitalit të investuar = Total asetet-obligimet	2.97%	4.15%	Tregon efciencën dhe profitabilitetin e investimeve kapitale të kompanisë. Sa më i madh është fitimi operativ marginal, aq më i madh është ky tregues. Caku: > 0
T5. Giring =borxhi total afatgjatë/kapitali			Aktualisht, KOSTT nuk ka borxh afatgjatë. Caku: < 60%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.4. Progresi me Planin e Biznesit

Progresi i KOSTT me Planin e Biznesit, më së miri mund të shihet, duke u nisur nga roli, misioni dhe vizioni, të cilat do të paraqiten në vijim:

Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar me ligjet e energjisë (Ligjin për Energji, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë) dhe në licenca. Poashtu, përgjegjësi e KOSTT-it është edhe bashkëpunimi me operatorët e sistemit të shteteve fqinje në marrëveshjet rajonale.

Misioni i KOSTT-it është që:


- Të ofrojë shërbime cilësore duke implementuar teknikat dhe teknologjitë më të avancuara për zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- Të sigurojë transparencë dhe të mos diskriminojë mes shfrytëzuesve të sistemit të transmisionit në një treg konkurrues të energjisë elektrike;
- Të promovojë qëndrimet e kompanisë në nivel rajonal dhe evropian.

Gjithnjë në përputhje të plotë me vizionin e vet, KOSTT synon që “Të jetë kompani financiarisht e qëndrueshme dhe fitimprurëse, e cila siguron transimion të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptim social dhe mjedisor dhe e integruar me rrjetet dhe institucionet evropiane të transmisionit të energjisë elektrike”.

Për të realizuar synimet e përcaktuara, janë vendosur edhe objektivat strategjike, të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2014 janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit transmetues të energjisë elektrike;
2. Avansimi i mirëmbajtjes së sistemit të transmisionit;
3. Siguria dhe besueshmëria e sistemit të transmisionit;
4. Krijimi i kushteve për operimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me zhvillimet e pritura;
5. Qëndrueshmëria financiare;
6. Pjesëmarrja aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal (të përfitojë nga zhvillimi rajonal dhe të kontribuojë në të);
7. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
8. Themelimi i zonës kontrolluese të KOSTT dhe implementimi i aranzhmaneve të reja operative

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 46 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

9. Vendosja e marrëdhënieve efektive me palët e interesit;
10. Të jetë punëdhënës atraktiv, që investon në zhvillimin profesional të punonjësve të vet;
11. Të jetë kompani e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor;
12. Të krijojë një ambient të sigurt pune.

Objektivat e lartcekura, do të jenë pikënisje për të analizohen të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2014, respektivisht, implementimi i këtij Plani të Biznesit.

Gjatë vitit 2014, janë realizuar 97 % të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes së nënstacioneve (që është mbi nivelin e realizimit në krahasim me vitin paraprak) dhe 92% të mirëmbajtjes nga ekipi i linjave e që është brenda normave të realizimit. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i autotransformatorëve, kontrollimi i nënstacioneve dhe linjave, shqyrtimi i rregullt i fushave, shqyrtimet e shpenzimeve vetjake nëpër nënstacione, remonti i fushave dhe linjave, etj.

Përveç kësaj, janë ndërmarr një mori aktivitete që kanë ndikuar në ngritjen e performancës, si Komisionimet i fushave të AT3 në NS Deçani, Kontrollimi vizual i stabilimenteve dhe operimi sipas kërkesave të QDN, realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve dhe shumë aktivitete të tjera që kanë ndikuar në ngritjen e performances operative.

Janë bërë avansime në ngritjen e funksioneve operative në monitorimin dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Duke filluar nga viti 2011 është mundësuar monitorimi dhe kontrolli në kohën reale i pjesës më të madhe të rrjetit transmetues të R.Kosovës. Pjesa e pa përfshirë në këto mundësi është pjesa veriore ku për shkaqe të njohura ende nuk është mundësuar përfshirja në këtë paket e NS Vallaq dhe HC Ujmani, pastaj nënstacionet e reja të ndërtuara dhe transformatorët e shtuar në ato ekzistuese, të implementuara pas përfundimit të projektit të SCADA\EMS & Telekom. Megjithatë, pas vendimit të Qeverisë për kalimin e aseteve të NS 110/x kV së bashku me shërbimet përcjellëse nga KEK në KOSTT, për operim dhe kontroll të sistemit duhet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin e ri. Kjo do të funksionalizohet në vazhdimë dhe po ashtu do të përfshihen edhe ndryshimet e tjera në rrjetin transmetues për shkak të zhvillimeve të rrjetit.

Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative të Bllokut Rregullues. Që nga shtatori 2013 është duke u shfrytëzuar platforma për parashikim të konsumit nacional "Load Forecast", e cila po gjeneron rezultate relativisht të mira, duke pas parasysh mos përfshirjen e tërësishme të rrjetit transmetues të Kosovës në SCADA\EMS.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 47 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Infrastruktura e matjeve komerciale ka përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes përdorimit të Fibre Optikut në pronësi të KOSTT-it.

Poashtu, është punuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepricën e kapaciteteve fiber optike. Si rezultat i kësaj pune u përpilua Plani i Biznesit për Operimin e shërbimeve të infrastrukturës në tregun e telekomunikimeve, e cila ishte edhe parakusht për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për aplikim për autorizim/licencë. Tani, kjo është licenca e tretë e KOSTT-it, së bashku me licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit dhe licencën për Operator të Tregut të energjisë elektrike, që kanë të bëjnë me biznesin themelorë të KOSTT-it. Dy licencat e para janë marr pas themelimit të KOSTT-it si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese si ndërrimin e HMI-ve, monitorëve, BCU-ve, përfshirjen e të dhënave të reja në SCADA lokale në pajtim me llojet e pajisjeve primare të zëvendësuar. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispeçerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Funksionalizimi i plotë i Qendrës Nacionale Dispeçerike Emergjente (rezervë),
- Krijimi i kushteve të interkonektimit me fibër optik me TSO-on e Maqedonisë për komunikime inter-TSO,
- Funksionalizimi i plotë i qendrës për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese NMS (Network Management System), kryesore në QND dhe asaj rezervë në QNDE, si dhe i radio sistemit telekomunikues,
- Instalimi i 20 RTU-SCADA sistemeve në nënstacione 110 kV/X kV, të cilat së bashku me sistemet ekzistuese të SCADA e furnizojnë me të dhëna sistemin SCADA/EMS,
- Revitalizimi i NS Prizreni 2 (tipit Alstom/Schnider)
- Përgatitjet për mundësimin e monitorimit të NS Prishtina 7
- Është bërë rindërtimi i TS Gjakova 1 me SCADA të re dhe pajisje primare të reja nga ana 110kV (tipit Schnider), që inkorporimi në Qendren Dispeçerike është bërë nga vetë inxhinierët e KOSTT-it (SCADA RTU),
- Në NS Skenderaji dhe NS Burimi janë në rindërtim shtimi i nga një trafo 110kV/10kV, ku po bëhet edhe shtimi i pajisjeve për kontroll dhe inkorporimi në SCADA EMS.
- Në implementim e sipër është projekti SCADA LFC në kuadër të projektit të linjës 400kV Kosovë – Shqipëri.
- Montimi i modemave me adaptera për komunikim përmes rrjetit fiber optik,
- Me ndihmën e inter-fejseve (ndërlidhjeve) TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohsisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 48 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

- Me ndihmën e inter-fejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i gati të gjitha objekteve elektroenergetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT - VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (PTK) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,
- Testimi periodik i njehsorëve dhe verifikimi i klasës së saktësisë të tyre,
- Përshtatja e sistemeve matëse me Kodin e Matjeve,
- Mirëmbajtja dhe leximi i të dhënave të matura për barazim përfundimtar nga njehsorët në Qendrën për lexim nga distanca(RMC-AMR), si dhe
- Administrimi dhe Operimi në RMC (Remote Metering Center), llogaritja dhe analiza e humbjeve teknike në transmision.

Nga aspekti i monitorimit dhe kontrollit të nënstacioneve është hedhë në tender inkuadrimit i monitorimit dhe kontrollit të të gjitha ndryshimeve të bëra në nënstacione 110/X kV në kohën e implementimit të projektit “SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni” LOT2 si dhe inkuadrimit i monitorimit dhe kontrollit të pajisjeve deri në kufirin e ri KOSTT-KEDS. Tenderi është në fazën e evalvimit. Me realizimin e këtij projekti KOSTT do të përmbyll të gjitha obligimet të veta që i ka në raport me kodin e operimit në krahasim me kufirin KOSTT-KEDS që është krijuar pas privatizimit të KEK shpërndarja.

Statusi i projekteve kapitale për 2014:

- 1) Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-1:SCADA/EMS, i financuar nga BK
Statusi i projektit: është i përfunduar dhe është në periudhën e mirëmbajtjes të përcaktuar më kontrat
Mjetet e paguara janë retantion money
- 2) Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-2: Telekom, i financuar nga BK
Statusi i projektit: është i përfunduar dhe është në periudhën e mirëmbajtjes të përcaktuar më kontrat
Mjetet e paguara janë retantion money
- 3) Kycja e NS 110/10 kV – Lipjani në linjën LP 212 (drejtimi NS Kosova A – NS Ferizaj 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it ;
 - *Statusi i projektit: i përfunduar*
- 4) Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806, drejtimi NS Gjakova 1 – NS Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
 - *Statusi i projektit: ka vonesa në implementim, Problemet e çështjeve pronësoro juridike për ndërtimin e pjesës së linjës LP 1806 kanë shkaktura vonesa të mëtejme në projekt .*
- 5) Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
 - *Statusi i projektit: i përfunduar ;*

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 49 nga 76
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

- 6) Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
 - *Statusi i projektit: projekti i kompletuar dhe është në periudhën garantuese*

- 7) Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1, financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi) ;
 - *Statusi i projektit: Projekti është në fazën e implementimit , punët po realizohen sipas planit dinamik . Janë Zbëvilluar debatet publike , naOÛ marrë lejet e ndërtimit për Segmentin e parë , Segmentin e dytë . Janë përfunduar bazamentet për 61 shtyllave si dhe është bërë ngritja komplet me konstrukcione metalike për 31 shtylla të linjës së tensionit 400kV, i tërë progresi i arritur në përqindje për këtë projekt është 24 .42%. Jemi në pritje të vendimit nga KfW në lidhje ECA application i cili siq duket po paraqet problem pasi garantuesi HBOR nuk është i ranguar sa duhet në KfW, dhe kjo sipas tyre e rrit riskun.*


- 8) Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2 financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi) ;
 - *Statusi i projektit: Periudha implementimit ka vazhduar sipas planit dinamik dhe është arritur një përqindje prej 24.41% e punëve të parapara për pjesën e nënstacionit NS. Kosova BProjekti ka pasur vonesa nga ana e OST-së në pagesën e avansit, prandaj ende nuk ka deri me tani ndonjë aktivitet. Është në diskutim , qështja e protokollit të komunikimit interkonektive të SCADA-s. Është mbetur diskutabile, qështja e modit të operimit të LFC me palën e OST-së.*

- 9) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, LOT 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it
 - *Statusi i projektit: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, kontrata e nënshkruar me 27.02.2013. Projekti është në fazën e implementimit . Për shkak të vonesave të shkaktuara n/ 5 fillim nga ana e kontraktorit KOSTT më vonë nuk ka mund të siguroj çkycje , e tërë kjo ka rezultuar me vonesë të implementimt . Deri më tani janë realizuar diku 60% e punëve*

- 10) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në dhe Prizreni 3 Lot 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
 - *Statusi i projektit: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3 është nënshkruar kontrata me 20.03.2013 . Projekti është në fazën e implementimit. Për shkak të vonesave të shkaktuara në fillim nga ana e kontraktorit KOSTT më vonë nuk ka mund të siguroj çkycje më vonë e tërë kjo ka rezultuar me vonesë të implementimt . Deri më tani janë realizuar diku 55% e punëve .*

- 11) Rehabilitimi i Shtyllave të LP.2298 220kV me Nr.24 dhe 25 dhe LP.1806 110kV me Nr.31 dhe 32, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
 - *Statusi i projektit: I përfunduar*

- 12) Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 50 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: I përfunduar*

13) Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos B, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: në shkurt të vitit 2014 është përfunduar dhe është në afatin garantues.*

14) Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos A, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: në Qershor të vitit 2014 është nënshkruar kontrata e projekti ka përfunduar në dhjetor 2014 – para kobe . Pagesa e projektit do të realizohet në vitin 2015 ;*

15) Instalimi i TR 2 në NS 110/10(20)kV në NS Skenderaj dhe NS Berivojcë. i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit:*

16) Furnizimi dhe Instalimi i Kabllit mbrojtës optik ne linjën interkonektive Kosove-Mali i Zi i financuar nga buxheti i KOSTT ;

- *Statusi i projektit: Kontrata është nënshkruar me 11.06.2014 dhe ka përfunduar mbrenda afatit për tre muaj .Projekti është në afatin garantues;*

17) Instalimi i Kabllit mbrojtës optik OPGW ne linjën 220kV NS Podujeve-NS Krushevc i financuar nga buxheti i KOSTT ;

- *Statusi i projektit: Kontrata është nënshkruar me 12.07.2014 dhe ka përfunduar mbrenda afatit për tre muaj .Projekti është në afatin garantues;*

18) "Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV –Prishtina 2 " i financuar nga buxheti i KOSTT;


- *Statusi i projektit: Kontrata është nënshkruar me 12.09.2014 dhe është në fazën implementuese*

19) "Instalimi I Grupeve Matëse sipas kufirit të ri KOSTT / KEDS " i financuar nga buxheti i KOSTT;

- *Statusi i projektit: Kontrata është nënshkruar me 04.11.2014 afati i përfundimit është 15.07.2016 . është paguar avansi . Projekti është në fazën implementuese;*

20) Shërbimet konsulente në kuadër të Projekteve IPA 2011 dhe IPA 2012 "Përmirësimi I Rrjetit të Transmisionit "i financuar nga KE donacion (IPA programi)dhe Kfw kredi

- *Statusi i projektit: Kontrata është nënshkruar me 07.04.2014 me kompaninë konsulentë Consuletra . Afati i përfundimit është në vitin 2017. Kompania konsulentë në bashkëpunim me stafin e KOSTT pas vizitave në teren dhe analiz/s së situatës aktuale ka përgaditur Specifikimin teknik dhe tender dosjen për projektet e përfshira në "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit ". Ofertat do të evaluoeh në janar të vitit 2015*

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajq 51 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Statusin e Zhvillimit të Projekteve kapitale gjatë vitit 2014 e ka përcjell edhe Komisioni i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it në takimet e mbajtura , ku edhe është informuar mbi të arriturat dhe vonesat në projekte .

Vlen të theksohet se duke e parë se investimet e parapara për vitin 2014 nga Donacionet kanë vonesa atëherë edhe me rishikim të buxhetit të vitit 2014 këto janë prolonguar derui në fund të vitit 2015.

Investimet e realizuar në Rrjetin e transmissionit gjatë vitit 2014 kanë ndikuar në arritjen e objektivave të KOSTT përmes rritjes së sigurisë në sistemit Elektroenergetik , plotësimin e kushteve teknike sipas ENTSO - E etj.

KOSTT ka vazhduar edhe aktivitetet lidhur me liberalizimin e Tregut të Energjisë elektrike në Kosovë.


Pas miratimit të Rregullave të Tregut është vazhduar puna në finalizim e Procedurave të Rregullave të Tregut për: alokimin e energjisë së matur, korrigjimin e matjeve, garacionin financiar dhe leximin, përafrimin dhe validimin e të dhënave matëse. Këto procedura janë dorëzuar në ZRrE për miratim.

Në përmbushjen e objektivave të KOSTT një nga të cilat është edhe integrimi rajonal, Operatori i Tregut ka vazhduar aktivitetin në arritjen e marrëveshjes operative mes KOSTT dhe EMS. Njëherit, është vazhduar edhe me aktivitetet për nënshkrimin e marrëveshjes Inter TSO me operatorët tjerë fqinj (OST,CGES,MEPSO).

Pas nënshkrimit të marrëveshjes operative me EMS, Operatori i Tregut do të fillojë procesin e skedulimit si dhe alokimin e kapaciteteve transmetuese interkonektive e që është obligim i çdo zone rregulluese. Lidhur me këto procese, edhe gjatë kësaj periudhe Operatori i Tregut është angazhuar maksimalisht në përpilimin e anekseve të marrëveshjeve Inter TSO me operatorët fqinjë për vitin 2015 duke ndërmarrë edhe aktivitetet e duhura në këtë drejtim. Ndër to është edhe riorganizimi i departamentit në mënyrë që të mbulohen të gjitha obligimet që dalin nga Rregullat e Tregut e që janë edhe pjesë të marrëveshjeve në fjalë.

Procesi i Nominimit Dry-Run i programeve ditore nga palët sipas metodologjisë ESS(ENTSO-E Scheduling System) përmes IT për Treg i filluar në Maj të 2013 ka vazhduar pa ndonjë problem sa i përket nominimit të palëve brenda zonës tregtare të KOSTT.

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është edhe përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka vazhduar edhe në vitin 2014 me projektin e sigurimit shëndetësor për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë. Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faje 52 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbush objektiven strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv.

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë nga aspekti social, KOSTT ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë për punëtorët e saj, duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë të standardeve më të larta, siç janë renovimet e ndërtesës, masat e ndërmarra për parandalimin e rreziqeve në punë dhe paisjet mbrojtëse në punë.

KOSTT edhe këtë vit, ka dëshmuar përgjegjësinë e saj nga aspekti social, duke ofruar mbështetje financiare për shkollim, duke siguruar bursa për studentë dhe mbështetje financiare për kryerjen e praktikës profesionale për studentë. Poashtu, është investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese.


Duke pasë parasysh se një nga objektivat e kompanisë është edhe përgjegjësia në aspektin mjedisor, KOSTT ka treguar një përkushtim të vazhdueshëm, me largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese, duke i kushtuar rëndësinë e merituar efikasitetit të energjisë me përdorimin e materialeve termike. Është bërë inspektimi/monitorimi në teren i objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes gjatë realizimit të projekteve, angazhimi mbi zhvillimin e projektit për riciklimin e mbetjeve nga letra, plastika dhe qelqi, përcjella gjatë procesit të largimit të eternitit me bazë asbesti nga fasada e vjetër e ndërtesës së KOSTT-it sipas ligjit për mbrojtje të mjedisit dhe udhëzimeve administrative nga MMPH, etj. Edhe këtë vit, ka KOSTT ka vazhduar me krijimin e hapësirave të reja për punë dhe hapësirave të gjelbëruara në NS, gjë që tregon se edhe më tutje ka vazhduar përkujdesja ndaj ambientit të punës në tërësi.

Ndërlidhur me procesin e menaxhimit të cilësisë, KOSTT është ricertifikuar për Menaxhim të Cilësisë sipas standardit ISO 9001:2008, përfshirë të gjitha NS-të e KOSTT, është realizuar integrimi i rrjetave të NS 110kV/x me rrjetin e KOSTT përmes infrastrukturës komunikuese, si dhe ka filluar implementimi praktik i projektit DMS (Sistemit për Menaxhimin e Dokumentacionit) dhe Arkivës Elektronike.

KOSTT-i operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (Zyra e Rregullatorit të Energjisë -ZRRrE). Korniza rregullative tangon KOSTT-in në shumë drejtime dhe raportet e tij me ZRRrE-në do të jenë kyçe për suksesin e KOSTT-it. Në këtë drejtim, janë dërguar në afatin e paraparë të gjitha dokumentet, raportet e rregullta dhe të dhëna apo raporte sipas kërkesave të ZRRrE-së dhe të MZHE-së.

Nga perspektiva e planit të biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave nga ana e ZRRrE-së. Në bazë të Rregullit për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, KOSTT ka dorëzuar te ZRRrE propozimin për të Hyrat Maksimale të lejuara për vitin 2014, si dhe aplikacionin për tarifa që do të zbatohen gjatë vitit relevant tarifor.

KOSTT konsideron se gjatë kryerjes së veprimtarive të saj të përditshme, vend të veçantë zënë marrëdhëniet efektive me palët e interesit, e që njëkohësisht paraqesin një nga

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 53 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

objektivat e saj strategjike. Prandaj, KOSTT edhe këtë vit ka vazhduar me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarët (Qeverinë e Kosovës), me palët e interesuara e posaçërisht me ZRRë, donatorët (Komisioni Evropian, KfW,USAID, etj), OST-të fqinje, përdoruesit dhe më gjërë, por edhe me institucionet financiare relevante.

2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2014

Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4
<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: <u>LOT-1:SCADA/EMS</u></i>	8,500,000.00 <input type="checkbox"/>	BK	7,875,370.00 <input type="checkbox"/>	31.12.2008	30.06.2011	Alstom/Komtel (F/RKS)	239,955.00 <input type="checkbox"/>



RAPORT VJETOR

ver. 1.0


DT-FI-010

faqe 54 nga 76


Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti


<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-2: Telekom</i>	9,500,000.00 <input type="checkbox"/>	BK	9,214,760.00 <input type="checkbox"/>	31.12.2008	30.06.2011	Energoinvest/Alstom(B&H/F)	32,480.00 <input type="checkbox"/>
<i>Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)</i>	1,050,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	1,397,094.32 <input type="checkbox"/>	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	1,606.60 <input type="checkbox"/>
<i>Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1 - Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1</i>	1,500,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	3,267,253.00 <input type="checkbox"/>	02.12.2011	29.06.2012 (120 ditë pune)	Ukab (RKS)/ELSA (Si)	726,723.73 <input type="checkbox"/>
<i>Rehabilitimi i pajisjeve të tenisonit të lartë (TL) 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1</i>	1,150,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	960,031.00 <input type="checkbox"/>	18.02.2012	14.05.2014	Enbi-Power (Al)	27,231.00 <input type="checkbox"/>
<i>Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2</i>	600,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	551,998.00 <input type="checkbox"/>	17.02.2012	06.05.2014	Ukab (RKS)	21,679.00 <input type="checkbox"/>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 55 nga 76
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti


LOT1: <i>Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Gjakova 2</i>	2,100,000.00 □	KOSTT	1,973,912.00 □	27.02.2013	20 muaj kalendarik	Ukab	573,983.20 □
LOT2: <i>Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3</i>	2,100,000.00 □	KOSTT	1,796,234.47 □	20.03.2013	20.11.2014	Ukab	443,141.81 □
<i>Furnizimi me softuerin E-Plan</i>	50,000.00 □	KOSTT	34,105.86 □	14.11.2012	23.11.2012	Komtel	3,410.58 □
<i>Rehabilitimi i Shtyllave të LP.2298 220kV me Nr.24 dhe 25 dhe LP.1806 110kV me Nr.31 dhe 32</i>	KOSTT	KOSTT	119,999.70 □	26.06.2013	24.09.2013	Elbndërtuesi - Eleganca	0.00 □

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 56 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


<i>Shërbime të Konsulencës për projektin e Linjës 400 kV Shtëpi - Kosovë</i>		KOSTT & KfW	KOSTT & KfW	1,676,192.51 □	24.09.2009		INTEC - GOPA	457,115.33 □
<i>Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1</i>	30,500,000.00 □	kfW & KOSTT (kredi)	30,773,968.59 (pa taxa e dogana) me taxa e dogan (36,000,000□)	28.02.2014	27.02.2016	Dalekovod d.d.	10,590,429.55 □	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 57 nga 76
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

<i>Sbërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV Fushe e TL dhe LFC - LOT 2</i>	5,500,000.00 <input type="checkbox"/>	kfW & KOSTT (kredi)	5,058,112.00 <input type="checkbox"/> (pa taxa e dogana)	30.04.2014	30.10.2015	ABB Gjermani	0.00 <input type="checkbox"/>
<i>Instalimi i TR 3 dhe pajisjeve të tensionit të lartë në NS Decani -bazuar në Marrëveshjen për Kyçje</i>	KelKos nje pjesë të vogël KOSTT	KelKos	76,540.59 <input type="checkbox"/> (pjesa e KOSTT -it)	04.09.2013	15.06.2014	KelKos/Komtel	76,560.00 <input type="checkbox"/>
<i>Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV - Kosova B & Instalimi i ndriçimit përgjatë saj</i>	450,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	380,150.00 <input type="checkbox"/>	20.03.2013	166 dite pune	Shpk. REXHIA	226,842.00 <input type="checkbox"/>
<i>Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve Rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kosova B</i>	150,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	57,814.40 <input type="checkbox"/>	30.09.2013	14.03.2014	Siemens (At)	49,142.24 <input type="checkbox"/>
<i>Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve Rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kosova A</i>	100,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTT	69,455.00 <input type="checkbox"/>	18.06.2014	22.01.2015	Siemens (At)	10,418.24 <input type="checkbox"/>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 58 nga 76
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

<i>Revitalizimi i Nenstacioneve NS 110 kV, ana 35 kV</i>	400,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTI	416,577.46	10.03.2014	23.02.2015	NP"MONTEN" dhe NTSH"ELING"	229,779.34 <input type="checkbox"/>
<i>Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV –Skenderaj dhe NS Burim</i>	1,500,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTI	1,538,601.00 <input type="checkbox"/>	25.04.2014	365 ditë pune	Hunday&Ballkan Petroll&Ukab	741,090.20 <input type="checkbox"/>
<i>Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo</i>	100,000.00 <input type="checkbox"/>	KOSTI	84,829.95 <input type="checkbox"/>	15.03.2013	25 dite pune	INES	0.00 <input type="checkbox"/>
<i>Ndërrimi i Përçuesve, Izolatorëve dhe Pajisjeve Lidhëse në Linjat 110 kV, Nr. 125/2 dhe Nr. 125/3</i>	KOSTI	KOSTI	1,959,800.80 <input type="checkbox"/>	29.06.2011	20.12.2011	Ukab - Elsa	0.00 <input type="checkbox"/>
<i>Furnizimi dhe Instalimi i Kabllit mbrojtës optik ne linjën interkonektive Kosove- Mali i Zi</i>	KOSTI	KOSTI	299,972.75 <input type="checkbox"/>	11.06.2014	19.09.2014	UMEL DALEKOVDMONTAZHA	299,972.75 <input type="checkbox"/>
<i>Instalimi i Kabllit mbrojtës optik OPGW ne linjën 220kV NS Podujeve-NS Krushevc</i>	KOSTI	KOSTI	163,092.52 <input type="checkbox"/>	12.07.2014	20.09.2014	UMEL DALEKOVDMONTAZHA	163,092.52 <input type="checkbox"/>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 59 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti


<p>“Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV -Prishtina 2 ”</p>	1,150,000.00 □	KOSTT	1,092,230.48	12.09.2014	28.09.2015	<p>“Hyundai Heavy industries CO Bullgaria-balkan Petroll Energy- NPT MONTEN”</p>	163,834.57 □
<p><i>Sbërbimet konsulente në kuadër të Projekteve IPA 2011 dhe IPA 2012 “Përmirësimi I Rrjetit të Transmisionit “</i></p>		KE/KfW / KOSTT	1,178,240.00 □	07.04.2014	Q1 2017	MW Decon	332,679.00 □

2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Përpjekjet e KOSTT-it, si edhe deri më tani, do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit, janë:


- Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë .Kjo njëkohësisht do të kërkojë edukim për përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesëmarrëse në tregun e energjisë dhe që siguron operim më eficient të sistemit elektrik. Në këtë drejtim, investimi në platforma të ndryshme softuerike është domosdoshmëri si dhe aftësimi për përdorimin e tyre është obligues (Softuer për zbatimin e moduleve që janë në SCADA/EMS, Kontrolla Frekuncë Fuqi-LFC, Balancimi i sistemit elektrik, blerja e humbjeve nga tregje, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DCAF- Day Ahead Congestion Forecast, Softuer për mbikqyrje të çastit, paisjeve të TL të tipit T5000, E-TERRA platforma softuerike.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 60 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Nënshkrimi i marrëveshjes për energji mes Kosovës dhe Serbisë e cila direkt do të ketë ndikim në regjimin e operimit të sistemit energjetik varësisht nga përcaktimi i dy TSO-ve

- Nevoja për adaptimet në zhvillimet e tregut të Kosovës. Kjo kërkon aftësi shtesë dhe zhvillim të procedurave të reja, konform modelit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe në përputhje me afatet e caktuara kohore. Njëkohësisht kërkohet edukim për përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesëmarrëse në tregun e energjisë dhe që siguron operim më eficient të sistemit elektrik. Në këtë drejtim, investimi në platforma të ndryshme softuerike është domosdoshmëri dhe njëkohësisht, aftësimi për përdorimin e tyre është obligues (Softueret e përfshira në SCADA/EMS, në kuadër të të cilave janë modulet për analizat para dhe pas operative, modulet për monitorim dhe kontroll në kohën reale të SEE të Kosovës, , Kontrolla Frekuncë Fuqi-LFC), platforma për operim në baza planifikuese në nivelin interkonektiv si DACF- Day Ahead Congestion Forecast, platforma për mundësimin e komunikimit autonom me TSO-ot tjera Europiane përmes infrastrukturës së telekomunikimit EH.
 - Eksploatimin maksimal të infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese
 - Krijimi i mundësive teknike në masë të konsiderueshme për realizimin e kontrollit të objekteve të rrjetit transmetues nga Qendra Nationale Dispečerike Kryesore dhe Emërgjente
 - Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS
 - Krijimi i kushteve teknike për monitorim të ndërsjell me TSO-të kufitare në kohën reale
 - Azhurnimi i kodeve teknike në përputhje me Kodet e operimit të ENTSO-e
 - Rritja e bashkëpunimit rajonal, nënshkrimi i marrëveshjeve të interkoneksionit, në përputhje me Ligjin e ri të Energjisë Elektrike dhe Politikave nga Doracaku i ENTSO-E dhe
 - Operimi në nivel interkonektiv në përputhje me rregullat e ENTSO-E
- Në aspektin e operimit gjatë planit afatmesëm do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuncë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshoj regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në dy varianta:
- Operimi në një zonë të përbashkët me Shqipërinë;
 - Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë.

KOSTT-i si Operator i Tregut, sipas ligjit të energjisë elektrike, është përgjegjës për propozimin e dizajnit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, përpilimin (draftimin) e rregullave të tregut dhe dorëzimin e tyre për miratim në ZRrE. Operatori i Tregut është përgjegjës për implementimin e Rregullave të Tregut dhe udhëheq procesin e modifikimit të tyre, varësisht zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe rajon.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 61 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Bucheti

KOSTT ka vazhduar aktivitetet lidhur me liberalizimin e Tregut të Energjisë elektrike në Kosovë. Aktivitetet e zhvilluara ishin në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë; kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktivat e Komisionit Evropian.

Procesi rreth hartimit të Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (DTEEK) i filluar në vitin 2010 ka përfunduar dhe në fillim të vitit 2013 DTEEK është aprovuar nga ZRRë. Që të jenë në përputhje me dizajnin e aprovuar të tregut janë modifikuar Rregullat e Tregut të cilat janë aprovuar gjatë vitit. Kjo kërkon zhvillim të procedurave të reja, konform Rregullave të Tregut dhe në përputhje me afatet e caktuara kohore e me këtë edhe aftësi shtesë në përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesëmarrëse në tregun e energjisë dhe që do të sigurojë një treg transparent.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë ende nuk është i njohur dhe i pranuar si zonë tregtare. Edhe më tutje në nivelin Evropian Tregu i Kosovës konsiderohet pjesë e Tregut të Serbisë. Pavarësisht kësaj Operatori i Tregut operon tregun e energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si një zonë tregtare në vete.

Në aspektin e operimit të tregut është planifikuar të studiohet edhe projekti i krijimit të një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri.


Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurtë me energji elektrike KOSTT, ERO, ERE dhe OST kanë diskutuar dhe analizuar idenë e bashkimit të dy tregjeve në një treg të përbashkët (një zonë tregtare). Tregu i përbashkët do të jepte sinjale të duhura për investime në kapacitete gjeneruese të reja dhe llojin tyre, për investime në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes si dhe nga tregu i përbashkët do të përfitonin konsumatorët nga të dy vendet .

Tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri gjithashtu do të mundësonte hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe do të krijonte kushte për një treg konkurrues.

Themelimi i një tregu të përbashkët për të gjitha afatet kohor është në harmoni me objektivat e BE dhe Komunitetit të Energjisë dhe kjo mund të konsiderohet si hap drejt integritimit në tregun rajonal të EJM.

KOSTT-i është duke punuar me të gjitha kapacitetet e veta që si Operator i Tregut dhe i Sistemit të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentet e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i do të:

- Përcjellë zhvillimet në rajon rreth tregut të energjisë elektrike
-
- Përbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Sigurojë që të gjitha kërkesat e operimit rajonal mund të përmbushen, posaçërisht standardet e ENTSO-E ;
- vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmisionit) fqinje;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 62 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal; dhe
- Kontribuoj në punën e CAO (Coordinated Auction Office) ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët.

Situatë të re në rrethinën afariste paraqet shthurja dhe privatizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut dhe transferi i Shpërndarjes dhe Furnizimit të konsorciumi privat Çalik&Limak i realizuar në maj të 2013.

KOSTT-i për sa i përket rrjetit të transmisionit përveç te transformatorët 110/35 dhe 110/10(20)kV të transferuara nga KEK-u, në pjesën tjetër ka zhvilluar infrastrukturën e nevojshme për të u përgjigjur kërkesave të kompanisë private të Furnizimit dhe Shpërndarjes.

Ashtu sic është theksuar më lartë, në rrethinën afariste ka ndikuar edhe kalimi i asetëve 110/35/10 kV dhe transformatorëve 220/35/10(20) dhe 110 kV, si dhe i fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK sh.a në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, të datës 03 Gusht 2011. Kjo nënkupton domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për të siguruar furnizim stabil dhe të sigurtë me energji elektrike gjatë dimrit të vitit 2013/2014, pasi që investimet në këto nënstacione 110/x kV nga KEK nuk kanë qenë të i mjaftueshme. KOSTT posedon "Politikën e Mirëmbajtjes " mbi bazën e të cilave mirëmban të gjitha pajisjet e sistemit, si dhe përmbushë obligimet në respektimin e rregullave, normave dhe kodeve teknike. Deri më tani Kostt ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet dhe masat preventive të nevojshme në mënyrë që asetet e transferuara nga KEK, të kenë një siguri më të madhe të operimit. Njëkohësisht është dukë investuar në rehabilitimin e këtyre NS-ve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre. Qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që të sigurojë një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe sigurisë në sistemin elektroenergjetik. Kështu, përmes aktiviteteve të duhura në sistem është arritur të krijohet një stabilitet i qëndrueshëm në funksionimin normal të sistemit. Duke iu falënderuar kësaj, si dhe investimeve të shumëta, KOSTT ka kaluar nga mirëmbajtja emergjente në mirëmbajtje preventive.


Plani i mirëmbajtjes për vitin 2014 del nga plani pesë vjeçar i mirëmbajtjes në të cilin janë të përfshira elementet kryesore, të cilat janë bazë për mirëmbajtjen e stabilimenteve elektroenergjetike, njëkohësisht janë aktivitete të cilat përmbushin normat dhe rregullat teknike.

Prioritet i KOSTT mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat kanë filluar të zhvillohen në sistemet e avansuara, duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve , në mënyrë që të kursethet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

2. 7. Rreziqet

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 63 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- pengesë për operim të plotë të IT për Treg edhe më tuje mbetet mungesa e EIC kodit për KOSTT si zonë tregtare. Përgjigjja në kërkesën e KOSTT për t'iu lëshuar një kod nga ENTSO-E ishte se: lëshimi i "10Y" EIC kodit për KOSTT është i lidhur me zgjidhjen politike mes Kosovës dhe Serbisë të pengesat
- vështirësitë financiare nga mosinkasimi i të hyrave;
- risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të qasjes së kufizuar në pjesën veriore të vendit, si dhe ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.
- Gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u

Vështirësitë do të paraqiten, sepse parashtrohet çështja se kërkesave të tregut të energjisë elektrike, a do të mund të i përgjigjen gjithë ata që do të aderojnë në këtë treg. Më e theksuar si problematikë do të jetë balancimi si mekanizëm i domosdoshëm që duhet të implementohet.

Në mënyrë që të ulët ndikimi në secilin rrezik, duhet ndërmirren veprimet:


- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS dhe anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Ndërrimi i regjimit të operimit të rregullimit të sistemit nga ai i Serbisë në atë vetjak dhe në bashkëpunim me Shqipërinë;
- Avancimi i operimit të sistemit të transmisionit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit dhe furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 64 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Aneks

1. Sponzorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2014 KOSTT ka ndarë 12,000.00 € në emër të bursave për studentët e Universitetit të Prishtinës, në emër të shpenzimeve për studentë që kanë mbajtur praktikën në Kostt 1,669 € për Komuna e Obiliqit 5,000.00€ për Sos-Kinderdof 2,000.00 € për Medica Kosova OJQ 5,000.00€ për Baleti Kombëtar i Kosovës 8,000.00 Në tërësi, janë ndarë 28,669.00 €.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 65 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

2.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2014

Struktura organizative aktuale është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it në korrik 2013 dhe përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti.

Struktura e menaxhmentit më të lartë të KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KSHE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Auditori i Brendshëm dhe udhëheqësit e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmisionit;
- Operatori i Tregut;
- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve;
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative;
- Financat;
- Burimet Njerëzore;
- Prokurimi;
- Drejtoria Qendrore, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Zyrën për Sigurinë Industriale dhe Mjedisin.

Numri i Punëtorëve

Me datën 1 Janar 2014, numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 368, ndërsa me datën 31 Mars 2014 numri i të punësuarve është 366, për shkak të pensionimit të dy punëtorëve.

Gjatë tremujorit të dytë, janë pensionuar edhe katër (4) punëtorë tjerë, kështu që me datën 30 Qershor 2014, numri i të punësuarve është 362.

Në fund të tremujorit të tretë (30 shtator), numri i punëtorëve ka rënë në 359, për shkak të vdekjes së tre punëtorëve.

Me 31 dhjetor 2014, numri i përgjithshëm i punëtorëve në KOSTT është 358, për shkak se edhe një (1) punëtor është pensionuar sipas fuqisë ligjore.

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it.



RAPORT VJETOR


ver. 1.0


DT-FI-010

fajqe 66 nga 76

Departamenti Financiar


Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti




	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 67 nga 76
Departamenti Financiar		Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore


Nr	Lënda nr.	Gjykata Kompetente	Paditës	I Padituri	Objekti i kontestit	Vlera e kontestit
1	P.nr.326/05	Gjykata Themelore Kaçanik	KOSTT	Nebih Bela, Veli Bela dhe Minir Mani	Vjedhje	2,370.00 □
2	P.nr. 2406/ 06	Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	Ivica Filipoviq dhe Millorad Iliq	Vjedhje	15,398.00 □
3	P.nr. 284/06	Gjykata Themelore Lipjan	KOSTT	Avdullah Bejtullahu dhe Afrim Bejtullahu	Vjedhje e rëndë	Nuk është përcaktuar
4	C.nr. 409/06	Gjykata Themelore Prishtinë	Hajrije dhe Milazim Zeka	KOSTT	Lirimi i banesës Hajrije dhe Milazim Zeka	Nuk është përcaktuar
5	C.nr.511/00 C.nr.2888/09	Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	Fadil Hashani, Halil Selmanaj, Besnik Zhitia Valdet Vatovci etj	Lirimi i lokaleve në Kurriz	Nuk është përcaktuar
6	C.nr. 2168/04	Gjykata Themelore Prishtinë	KEK / KOSTT	Kadri Rukovci	Lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz	Nuk është përcaktuar
7	C.156/09	Gjykata Themelore Prizren	KOSTT	Qamil Kabashi	Kompenzim dëmi	11,020.00 □
8	C.nr.571/11	Gjykata Themelore Skenderaj	Shaqir Duli	KOSTT/Komuna Skenderaj	Kompenzim dëmi	10,000.00 □
9	C.nr.1559/06	Gjykata Themelore Prishtinë	Selvije Dedinca, etj.	KOSTT	Pagesa e Rentës.	600.00 □ (pagesë mujore)
10	C.nr. 270/07 C.nr.202/14	Gjykata Themelore Podujevë	Mustafë Hasani etj	KOSTT	Kompenzim dëmi	100.000,□ (Vlera fillestare) 1,242,910.00 □ (vlera e fundit)
11	C.nr.218/11	Gjykata Themelore	Fevzi Nebihu	KOSTT/Komuna Ferizaj	Pengim Posedimi	1,600.00 □

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 68 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

		Ferizaj				
12	C.nr.2255/06	Gjykata Themelore Prishtinë	Xhemile Berisha	KOSTT	Kompenzim demi në formë të ushqimit	400.00 □ (vlerë mujore)
13	P.nr. 184/12	Gjykata Themelore Gjakovë	KPA/ Prokuroria Gjakovë	Murteza Zhavelli	Lirim Objekti (Pushtim i pa ligjshëm të pronës)	Lënda e përfunduar
14	E.nr.281/06	Gjykata Themelore Lipjan	KOSTT	Momqillo Mitiq	Kompenzim demi	2,176.50 □
15	C.nr.244/2013	Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	KEK	Kompenzim demi	140,285.56 □
16	C.nr. 0002/2012	Gjykata Themelore Mitrovicë-Dega Skenderaj	Shaban Emini	KOSTT/ Komuna Skenderaj	Kompenzim demi	Lënda e përfunduar
17	P.nr.69/12	Gjykata Themelore Gjakovë	KOSTT	Haki Morina	Lirim Objekti (Pushtim i pa ligjshëm i pronës)	Lënda e përfunduar
18	C.nr.826/11	Gjykata Themelore Prishtinë	Limon Hashani	KOSTT	Kompenzim i dëmit Ekonomik per vendosjen shtyllës se linjës si dhe kërkesë që t'i alokohet shtylla nga paluajtshmëria e tij	Lënda e përfunduar
19	C.nr.438/10	Gjykata Themelore Ferizaj	Kenan Mehmeti	KOSTT	Kompenzim demi në formë të rentës me rastin e lëndimit trupor	30,938.26□.
20	Nd.nr. 42/09	Gjykata Themelore Rahovec	Agron Vuçitërna	KOSTT/KEK	Kompenzim demi - në vend të kompenzimit me rastin e vendosjes së shtyllës t'i	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 69 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

					krijohet një qasje e re energjetike në pronën e tij	
21	C.nr.116/13	Gjykata Themelore Gjilan	Xhevat Qerimi	KOSTT/KEK	Kompenzim dëmi lidhur me banesën që gjendet në TS Gjilani 1	Nuk është përcaktuar
22	C.nr.58/14	Gjykata Themelore Pejë	Hetena Cikotiq	KOSTT	Të drejtën e blerjes së banesës	Nuk është përcaktuar
23	C.nr.127/14	Gjykata Themelore Pejë	Hamdiija Cikotiq	KOSTT	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
24	P.nr.91/14	Përmbauesja Privat Emine Sherifi	Ujësjiellësi Rajonal Prishtina	KOSTT	Propozim për Përmbauesja	9,921.25 □
25	C.nr.205/12	Gjykata Themelore Isotg	Ramiz Zeqëb Shala	KOSTT	Kompenzim dëmi me rastin e prerjeve të drunjtëve	Lënda e përfunduar
26	A.nr.	Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti për çështje administrative	KOSTT	Organi Shqyrtues i Prokurimit OSHP	Propozim për lëshimin e masës së përkohshme	Nuk është përcaktuar
Total KOSTT i paditur						1,438,831.57 □
Total KOSTT padites						28,788.00 □

	RAPORT VJETOR		DT-FI-010
	ver. 1.0		faqe 70 nga 76
Departamenti Financiar		Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

2.3. Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2014 nga burimet e KOSTT

<u>Nr</u>	<u>Departamenti</u>	<u>Lloji i Prokurimit</u>	<u>Nr I Procedurës</u>	<u>Emri I Projektit</u>	<u>KONTRAKTORI</u>	<u>Vlera e Kontratës</u>	<u>Vlera e Realizuar e Kontrates</u>	<u>Vlera e mbetur për realizim</u>	<u>% e realizimit</u>
1	Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Procedurë e Hapur	84/12	Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH	konz:Monten&G3 Engineering	2,327,240.19	349,086.02	1,978,154.17	15%
2	Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Procedurë e Hapur	39/13	Instalimi i TR2 në NS 110/10(20) - Skenderaj	konz: Hyndair Ballkan Petroll Energy-UKAB	1,538,601.28	741,090.19	797,511.09	48%
3	Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Procedurë e Hapur	79/13	Furnizimi dhe Instalimi i TR3,40MVA në NS 110/10 kV - Prishtina 2	MONTEN	1,092,230.48	163,834.57	928,395.91	15%
4	Departamenti i	Procedurë e	85/13	LOT 2: upgrade and update the	konz: ALSTOM	1,092,071.85	190,020.50	902,051.35	17%



Departamenti Financiar

RAPORT VJETOR

ver. 1.0

DT-FI-010

Sfaqe 71 nga 76

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

OS	Hapur	SCADA/EMS system in the KCS and EKCS system	& KOMTEL				
5	Departamenti i Burimeve Njerëzore Procedurë e Hapur	Shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të KOSTT sh.a	Delta Security	740,000.00	0.00	740,000.00	0.00%
6	Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri Procedurë e Hapur	Revitalizimi i Nënstacioneve NS 110kV, ana 35kV	konz: Monten & Eling	416,577.46	62,486.62	354,090.84	15%
7	Departamenti i Operatorit të Transmisionit Procedurë e Hapur	Furnizim me shylla emergjente	ENERGOINVEST	300,000.00	0.00	300,000.00	0.00%
8	Departamenti për Çështje Ligjore dhe Rregullative Procedurë e Hapur	Sherbime kadastrale dhe juridike per bartjen e pronesise se asetete të KOSTT	konz:INTERSH PED&ITEG	300,000.00	74,257.76	225,742.24	25%

**RAPORT VJETOR****DT-FI-010**

ver. 1.0

faqe 72 nga 76

Departamenti Financiar


Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

9	Departamenti i OS	Procedu rë e Hapur	28	Furnizimi dhe Instalimi i kablilit mbrojtës optik ne linjen interkonektive Kosove- Mali i Zi	UMEL DALEKOVOD MONTAZA	299,972.75□	284,974.11□	14,998.64□	95%
10	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Procedu rë e Negociuar Publikim të Kontratës	40	Procedure e Negociuar: Sigurimi Fizik i objekteve te KOSTT sh.a.	LEO SECURITY	214,000.00□	116,328.96□	97,671.04□	54%
					TOTALI	8,320,694.01□	1,982,078.73□	6,338,615.28□	23.82%

Shpjegim: - Përqindja e realizimit prej 23.82 % paraqet përqindjen për dhjetë projekte më të mëdha . Numri i projekteve të kontraktuara për vitin 2014 deri tani është 102 (per vlerat ne mbi 1,000.00Euro).

Vlera e të gjitha kontratave të kontraktuara është : **10,936,533.31 □**


Realizimi total i të gjitha kontratave është 3,370,158.48 □, që do të thotë, në përqindje 30.81 %

 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR ver. 1.0	DT-FI-010 faqe 73 nga 76
	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

2.4. Sygjerime dhe propozime për rritjen e performancës

Në mënyrë që KOSTT të rritë edhe më tutje performancën, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Vazhdimi të ngritjes së eficiencës në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit
- Implementimit të projekteve kryesore që risin kapacitetet e operimit e që lidhen me operimin e mëvetëshëm të KOSTT;
- Vazhdimi i trajnimit të stafit dhe formave tjera të zhvillimit për përcjellje të ndryshimeve teknologjike që rritë shkathhtësitë dhe njohurit për ngritjen e eficiencës në KOSTT;
- Vazhdimi i shqyrtimit të masave motivuese për stafin për ngritjen e kualitetit të punës së tyre.
- Përmirësimet në asetet e transferuara nga KEK-u dhe futja e teknologjisë për monitorim, kontroll, matje dhe operim, pajisja e të gjitha objekteve (NS-ve)
- Përgatitjet për implementimin e Rregullave të Tregut

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 74 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Lista e shkurtesave

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)

AKP - Agjencioni Kosovar i Privatizimit

AIT - (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

ATC - (Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i disponueshëm

ATR - Autotransformatori

AUK - Universiteti Amerikan i Kosovës

BCU- (Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BD - Bordi i Drejtorëve

BK - Buxheti i Kosovës

BNJ - Burimet Njerëzore

CGES- (crnogorski Elektro Sistem) - OST i Malit të Zi

CHF - Franga Zvicerane

DMS-(Documents Management System) – Sistemi për menaxhimin e dokumentacionit

ECLO - (European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EJL - Evropa Juglindore

EKCS - Qendra Dispečerike Emergjente

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë


ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pafurnizuar

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

FAC- (Final Acceptance Certificate) – Çertifikata e pranimit final

GSM -(Global System for Mobile Communication) - sistemi i përgjithshëm i komunikimit mobil

GJK - Gjykata Komunale

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 75 nga 76</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

GjQ - Gjykata e Qarkut

HC - Hidrocentral

HMI - (Human Machine Interface) - ndërlidhja makinë-njeri

HVM- (High Voltage Metering) - matësi i energjisë

IKP - Indikatorët Kyç të Performancës

IPA- Instrumentet para anmtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC - Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmisionit)

KA - Konflikt Administrativ

KCS - Qendra Dispeçerike Nacionale

KE – Kryeshefi Ekzekutiv

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale

LP - Larpërçuesi

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planit Hapsionor

MPI - Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria

MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NEF (Net Export Flow) - Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) - Importi neto për nevojat e Kosovës

NMS - (Network Management System) - Sistemi për menaxhimin e rrjetit


NS - Nënstacioni

NP - Ndërmarrjet publike

NJPMNP - Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OPGW - fibri optik

OS - Operatori i Sistemit

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 76 nga 76</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

OST - Operator i Sistemit të Transmisionit

OT - Operatori i Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

PZhT - Plani Zhvillimor i Transmisionit

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managament System)
-Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

SSE - Sistemi Elektro Energjetik

TC A - Termocentrali Kosova A

TC B - Termocentrali Kosova B

TCP/IP - (Transport Communication Protocol) -Internet protokole të komunikimit

TE- (Transmitted energy)- Energjia e transmetuar

TKE- Traktati i Komunitetit të Energjisë

TI - Teknologjia e informacionit

TMR - Transformatori mtës i rrymës

TL - Tensioni i lartë

ToR (Terms of Reference) - Termat e Referencave

TP - Tatimi në pronë

TTC - (Total Transfer Capacity) - kapaciteti total i bartjes

USAID - (Unated States Agenci for International Development) - Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

USEA - (US Energy Association)- Asociacioni Amerikan për Energji

ZRrE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë

ZSZ - Zyra e Sigurisë nga Zjarri